

# *Kosova dhe Sllovenia - dy Ngjarje, dy Rrugë, dhe sfida të ndryshme*

*Krahasimi i trendëve demografikë në Republikën e Kosovës dhe  
në Republikën e Sllovenisë në shekullin e kaluar*

*Sabina Žnidaršič Žagar\**

## **Abstrakt**

Punimi bën krahasimin e zhvillimeve demografike të Republikës së Sllovenisë dhe të Republikës së Kosovës gjatë dekadave të fundit. Qëllimi kryesor është që të cekën dallimet e rëndësishme dhe shkaqet e evolucionit të ndryshëm të tranzicionit demografik në këto dy mjedise. Në të parën, tranzicioni përfundoi në fund të shekullit të kaluar, ndërsa në të dytën tranzicioni gjendet vetëm në fazën e parë. Përderisa Republika e Sllovenisë gjendet sot në një situatë post-tranzicionale, të karakterizuar nga një ndryshim i konsiderueshëm i marrëdhënieve ndër-gjeneratave, Republika e Kosovës është ende një shoqëri në tranzicion me të dhëna statistikore për lëvizje të popullatës që tregojnë që Kosova duhet të ballafaqohet me sfida të pa shembull (që gjithashtu) lidhen me ndryshime të parashikuara radikale në strukturat e natalitetit të popullatës.

**Fjalët kyç:** Republika e Kosovës, Republika e Sllovenisë, tranzicioni demografik, nataliteti, mortaliteti, vdekja e foshnjave, gjinia mashkullore dhe femërore.

---

\* Profesoresha Sabina Žnidaršič Žagar, Ph.D., është mësimmthënëse në Fakultetin e Shkencave Humane në Universitetin e Primorskës si dhe hulumtuuese në Institutin e Studimeve Historike të Shkencave dhe Hulumtimeve në Qendrën Koper. Fusha kryesore e hulumtimeve të saj është historia e femrave në shekujt 19 dhe 20, me përqendrim të veçantë për temat si: puna e femrave, profesioni, pamjet dhe imazhet e femrave në shoqërinë sllovene. Ajo është edhe autore e monografisë *Ora et labora – in molči, ženska!* [*Ora et labora – Dhe mbaje gjuhën grua!*] (2000) si dhe e udhëzuesit mësimor: *Ženski so pa vzasle svetlejšë dolžnosti nego kuhati in prati* (*Ka detyra më të lehta për t'u bërë grua se sa larja dhe gatimi*, 2008).

Edhe pse Republika e Kosovës dhe Republika e Sllovenisë kanë qenë pjesë e shtetit të njëjtë që nga mbarimi i Luftës së Parë Botërore deri rreth viteve 1990, ato nuk kanë qenë të ndara vetëm nga distanca më e madhe gjeografike në Jugosllavi, por edhe nga ritmi dhe orientimi i zhvillimeve të brendshme, ku kishte dallime të cilat janë pasqyruar në trendët demografikë të këtyre dy rajoneve. Përderisa tranzicioni demografik në Republikën e Sllovenisë filloi dhe mbaroi gjatë dyqind vjetëve të fundit, zhvillimi i këtij tranzicioni në territorin e Kosovës ishte i ndryshëm: filloi më vonë se në Slloveni, arriti kulmin e fazës së parë gjatë regjimit socialist në Jugosllavi dhe ishte, në thelb, i shoqëruar nga zhvillimet politike të dekadave të fundit të shekullit 20. Gjatë gjithë kohës, ai ishte i penguar dukshëm nga modernizimi i zgjedhur nga forcat politike.

Pengesa më e madhe që u shfaqet hulumtuesve sot rreth lëvizjeve demografike në territorin e Republikës së Kosovës është gjetja e të dhënave statistikore. Përderisa Republika e Sllovenisë përmban një databazë të përgjithshme statistikore për së paku njëqind e pesëdhjetë vjet, territori i Kosovës pati së paku dy regjistrime të përgjithshme për mbledhjen e të dhënave. Regjistrimi i parë ndodhi para krijimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, ndërkaq i dyti në dekadën e fundit të shekullit 20, më saktësisht pas regjistrimit të vitit 1981, kohë që u shoqëruara me ngritje të trazirave politike. Sot, nuk mund të harrohen përpjekjet e shquara të Zyrës Statistikore të Kosovës për të siguruar të dhëna të rregullta të popullatës nga viti 2002, e as nuk mund të pritët për regjistrimin e parë të popullatës në shtetin e ri. Me shikimin e problemeve të sipër përmendura rreth grumbullimit të dhënave, kjo ese do të përqendrohet në trendët më të rëndësishëm në lëvizjet e popullatës dhe do të shtrojë pyetjet përkatëse, gjysma e të cilave, do të mbeten pa përgjigje për shkak të natyrës së vështirë për grumbullimin e të dhënave. Si shteti me përqindjen më të lartë të popullatës së re, rritjen e lartë natyrale të popullatës si rezultat i natalitetit relativisht të lartë dhe mortalitetit skajshmërisht të ulët, numrit të madh të martesave, numrit të madh të lindjeve jashtë-martesore si dhe mashkullisë së lartë, Republika e Kosovës përbën një nga strukturat më sfiduese të popullsisë në Evropë. Të dhënat për vitet e fundit shfaqin disa ndryshime kritike që

paraqesin një lëvizje të vazhduar të evolucionit të tranzicionit demografik. Vendi është duke përjetuar një zbritje të konsiderueshme në shkallën e natalitetit, e cila i është afruar shkallës së vendeve të BE-së, sikur Irlandës. Gjithashtu, mund të vërehet edhe lidhja ndërmjet zbritjes së shkallës së natalitetit dhe zbritjes së numrit të foshnjave të vdekura. Këto dy procese janë të lidhura sipas rastit dhe kohës (sipas të dhënave të UNMIK-ut, viti kthesë ishte 1989/90, kur Kosova përjetoj rritje të dhunës). Për më tepër, të dhënat tregojnë një zbritje graduale mashkullie në të gjitha moshat, struktura e mjedisit duke qenë një nga elementet kyçe të këtij ndryshimi të proporcionit gjinor (kjo zbritje është dalluar në mjediset urbanistike). Ndër faktorët më të rëndësishëm që shfaqin dhe ndihmojnë në ndryshimet radikale të lëvizjeve të popullsisë së Kosovës janë, pa dyshim, të lidhura me proceset e modernizimit dhe me përhapjen dhe përdorimin e dijenisë së re dhe teknologjisë. Për disa dekada, realiteti kosovar ishte i dominuar nga konflikte dhe armiqësi ndëretnike, që la njolla të pashlyera në jetën e secilit dhe të çdo individ, dhe që sot sfida kryesore e shtetit kosovar është krijimi i përmbushje së nevojave dhe planeve individuale. Duke pasur parasysh që gjinia femërore me nevojat e saj specifike gjithmonë ka dëshmuar të jetë një indikator i rëndësishëm për zhvillimin dhe modernizimin e një shoqërie, duke lënë anash hulumtimin e mjedisit, në të ardhmen duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje pozitës së femrave. Çfarë mendojmë nuk është çështja e statusit legal të barabartë ndërmjet dy gjinive, gjë që nuk është në pyetje në rastin e Republikës së Kosovës, por çështjet specifike gjinore. Mbi të gjitha, modernizimi i një shoqërie të caktuar varet edhe nga aftësia për të pasur në konsideratë, pranuar dhe përkrahur dallimet dhe nevojat, përfshirë ato gjinore të popullatës së saj.

Lidhja e Republikës së Kosovës dhe Sllovenisë nuk vjen vetëm nga bashkëjetesa njëqindvjeçare.

Në kulmin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, gjë që ndodhi gjatë viteve 1980 kur ish shteti i përbashkët përjetoj tensione më të larta politike, dy krahinat zhvilluan një lidhje të ngushtë. Mund të thuhet që situata kritike në Kosovë ishte nxitëse për kombin slloven dhe lidhshpimin politik që të artikulojë mosmarrëveshjen e vet për herë të parë me autoritetet në

Beograd, gjë që përfundoi duke parë Slloveninë si shtet federal. Këto dy krahina, që patën shumë pak të përbashkët (përveç migrimit ekonomik të njëanshëm, tregtisë sezonale të mallrave si dhe të ëmbëlsirave), u kthyen nga interesat e përbashkëta në luftë me autoritetet qendrore. Përbrenda ish-Jugosllavisë, ato nuk kanë qenë të ndara vetëm nga distanca më e madhe gjeografike në Jugosllavi, por edhe nga ritmi dhe orientimi i zhvillimeve të brendshme dhe, si rezultat i modernizimit të shekullit të 20-të, në këto dy mjedise u formuan dy realitete të ndryshme, shoqërore, ekonomike në fushën politike apo në nivel të marrëdhënieve personale ditore.

Kjo ese do të shtjellojë trendët në lëvizjet e popullsisë që jo vetëm nuk ishin te njëjta në të dy regjionet, por gjithashtu rezultuan në realitete plotësisht të ndryshme. Të dhënat statistikore do të përdoren për të krahasuar ato si dhe për të theksuar dallimet më të rëndësishme në mes dy vendeve, si dhe për të parashikuar evolucionin potencial në të ardhmen. Në mënyrë që të shpjegojë ndryshimet e veçanta, ky hulumtim do të fokusohet veçanërisht në zhvillimin e tranzicionit demografik në Kosovë - territor ky në të cilin tranzicioni u shoqërua nga një model ndryshe prej atij slloven (si dhe shumicës së Evropës), i paparashikuar nga teoritë e tranzicionit - gjithashtu do të shtjellohet tema e rritjes natyrale të popullsisë në relacion me trendët e mortalitetit dhe natalitetit, si dhe të ketë theksim të veçantë në lindje të frytit të vdekur dhe vdekshmërisë tek foshnjat (si indikatorë të nivelit të modernizimit) dhe mashkullisë së lartë. Një nga problemet më të mëdha me të cilin hulumtuesit ballafaqohen, është krahasimi i burimeve në dispozicion dhe i të dhënave në këto burime. Republika e Sllovenisë përmban një databazë statistikore gjithëpërfshirëse me informata për periudhën prej mes shekullit 19-të, p.sh. prej vitit 1857 kur Monarkia Austriake bëri regjistrimet e rregullta të popullsisë, duke përfshirë atë sllovene, në pajtim me standardet moderne. Në rastin e Kosovës, duhet të merren parasysh së paku dy regjistrime të mëdha për grumbullimin e të dhënave: i pari u krye para krijimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, ndërsa i dyti gjatë rritjes së tensioneve politike ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Për më tepër, nga pikëpamja shkencore, të dhënat e lidhura me periudhën nga regjistrimi i fundit jugosllav i vitit

1981 e deri në ditët e sotme, janë të dyshimta dhe të papërfunduara. Zyra e Statistikave të Republikës së Kosovës (që nga tani: ZSK) që nga viti 2002 ka lëshuar raporte të (paku)tueshme<sup>1</sup> si dhe ka qenë duke përfunduar përgatitjet për regjistrimin e parë të përgjithshëm në Republikën e Kosovës. Një problem tjetër i madh është i lidhur me refuzimet për regjistrim dhe mbledhje të të dhënave nga individë të etnisë serbe dhe/ose shqiptare. Për gjatë dy dekadave të fundit, natyra problematike e mbledhjes së të dhënave adekuate është reflektuar qartë, si për shembull, në ekzistimin e llogaritjeve të ndryshme për numrin e përgjithshëm të popullatës kosovare (burime të ndryshme publikojnë numra të ndryshëm), duke u bazuar në faktet që disa të dhëna nuk janë mbledhur apo përpunuar etj. Në shumicën e rasteve, eseja do të mundohet t'i shmanget këtyre situatave të papërshtatshme duke u fokusuar më shumë në trendët se sa në të dhënat specifike (p.sh. rritjen natyrale të popullsisë) dhe duke shtruar pyetje e jo duke iu përgjigjur rasteve që mundohet të bëhen shpjegim i situatës së tanishme të çështjeve dhe problemeve përmes të dhënave statistikore dhe indikatorëve (p.sh. arsyet e mashkullisë së lartë).

(Së paku) përbrenda sipërfaqes evropiane, realiteti demografik i territorit të Republikës së Kosovës është shumë specifik, gjë që e bën atë si temë shumë interesante për hulumtim. Kosova jo vetëm që shfaq rritjen më të shpejtë të popullsisë (falë riprodhimit natyral) dhe strukturën më të re të popullsisë, por gjithashtu nivel të lartë martesor së bashku me një nivel të lartë të lindjes së lartë jashtë-martesor (fëmijëve të

---

<sup>1</sup> Statistikat kombëtare gjithmonë në mënyrë të paqëllimtë reflektojnë interesat e ngushtë të një atij shteti (gjë që krijon faktin që shtetet më të përparuara, përfshirë Slloveninë, po konsiderojnë seriozisht mundësinë e ndaljes së mbledhjes së informative nga regjistrimet e rregullta); interesat e popullsisë së një shtetit janë të varura nga vetëdija e problemit kombëtarë si dhe pikave kritike. Prandaj, shteti është kryesisht i interesuar në ato çështje që besohet së kërkojnë kujdes të veçantë në kohën e tanishme dhe në të ardhmen. Për arsye të qarta, që një kohë të gjatë Kosova i ka kushtuar kujdes të plotë çështjeve etnike dhe kujdes të përgjysmuar atyre çështjeve që ne i shohim si interesante dhe me rendësi kyçese për zhvillim të orientuar kah modernizimi i shoqërisë kosovare.

parë) si dhe mashkulli të lartë. Në një rën anë, trendët demografikë kanë një ndikim direkt në dy segmentet e tjera të strukturës së popullsisë: ato shoqërore-ekonomike si dhe ato shoqërore; ndërsa në anën tjetër, ato janë “robërit” e tyre. Edhe nëse eseja nuk i kushton rëndësi të veçantë këtyre pyetjeve, duhet të përmenden lidhjet më të rëndësishme dhe ndërmarrëdhëniet: papunësia e lartë, struktura e pa balancuar e sektorit individual në ekonominë kombëtare, struktura e ultë e edukimit të popullsisë. Mund edhe të merret si çështje e studimit tema gratë/femrat në Kosovë: ato formojnë një grup minoritar, janë më pak të shkolluara se meshkujt, lindin në moshë të re dhe anojnë kah martesë pas lindjes së fëmijës së parë, jeta e tyre e rrezikuar shumë nga lindja. Në krahasim me grupet e tjera, femrat janë gjithmonë indikator i mirë i modernizimit të (pa)suksesshëm duke lënë anash tipin e mjedisit të hulumtuar.

### *Tranzicionet demografike*

Tranzicionet demografike<sup>2</sup> filluan dyqind vjet më parë në territorin e sotëm të Republikës së Sllovenisë dhe mbaruan në rritje negative natyrale, duke u siguruar një rritje të ngadalshme të popullsisë vetëm falë ardhjes së imigrantëve. Të dhënat për territorin e sotëm të Republikës së Kosovës, në të kundërtën, tregojnë që tranzicioni demografik filloi më vonë, arriti kulmin e fazës së parë – karakterizuar me zvogëlim të mortalitetit dhe rritje të nivelit natyral të rritjes së popullsisë – gjatë kohës së

---

<sup>2</sup> Termi “tranzicion demografik” paraqet një nga dimensionet tipike të tranzicionit prej një shoqërie tradicionale në atë modern. Në fushën demografike, ai manifestohet si një lëvizje e shkallëve të lindjes dhe vdekjes nga nivele të larta në të ulëta, me një periudhë të tranzicionit që karakterizohet me rritje natyrale të popullsisë si rezultat i zvogëlimit të shkallës së mortalitetit që zakonisht e paraprinin zvogëlimin në natalitet. Tranzicioni demografik duhet të merret parasysh së bashku me proceset tjera tranzicionale: industrializimi ekonomik dhe transformimi politik. Shumica e pjesës së Evropës përjetoj një gërshetim intensiv të këtyre proceseve gjatë shekullit 19 dhe 20, që përfundimisht i riformuan shtetet evropiane (dhe tjera).

Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, dhe ishte në thelb i ndikuar nga zhvillimet në dekadat e fundit të shekullit 20. Kthimi gjatë këtij shekulli përjetoi fazën e dytë të tranzicionit të karakterizuar më një zvogëlim gradual në shkallën e natalitetit.

Tabela 1: Tranzicioni demografik në Slloveni<sup>3</sup>

Periudha	Nataliteti	Mortaliteti	Rritja/zbritja natyrale	Rritja / zbritja e migrimit	Lindjet jashtë - martesore
1754-1779	36.3	32.8	3.5	-0.7	/
1780-1819	34.0	35.6	-1.6	-0.1	/
1818-1846	34.6	26.1	8.5	0.2	/
1846-1857	32.0	28.7	3.3	-3.7	/
1858-1869	33.4	26.5	6.9	-2.7	16.4
1870-1880	34.4	28.1	6.3	-2.1	10.5
1881-1890	35.1	27.0	8.1	-3.8	9.9
1891-1900	34.8	26.2	8.6	-5.9	8.5
1901-1910	34.0	23.5	10.5	-6.4	7.7
1911-1920	25.9	23.5	2.4	-4.2	/
1921-1930	28.7	17.7	11.0	-4.6	/
1931-1940	23.4	15.0	8.4	-4.4	9.9
1941-1947	20.3	16.1	4.2	-4.4	/
1948-1952	23.3	12.2	11.1	-2.3	11.7
1953-1961	19.7	9.7	10.0	-2.9	10.7
1961-1970	17.8	9.9	7.9	-2.5	9.2
1971-1980	16.8	10.2	6.6	2.4	10.5
1981-1990	13.8	10.4	3.5	0.5	19.3
1991-2000	9.7	9.8	-0.1	2.3	31.0
2001-2004	8.8	9.4	-0.6	1.3	41.7

Fillimi i tranzicionit demografik në Slloveni mund të futet në fillimin e shekullit të 19-të kur shkalla e mortalitetit ra në më pak se 30%. Për gati njëqind vjet më vonë, u shoqërua me një rritje në mes të shekullit të 19-të, Sllovenia përjetoi zbritje të shkallës së natalitetit: në fillim të shekullit të 20-të, nataliteti ra për 30%. Qysh atëherë, si nataliteti ashtu dhe mortaliteti, ishin në zbritje konstante deri në fund të shekullit, kur ato së bashku ranë nën nivelin 10%. Pas një periudhe të gjatë të rritjes

<sup>3</sup> Šircelj, Milivoja, *Rodnost v Sloveniji od 18. do 21. stoletja*. Ljubljana: Statistični urad Republike Slovenije, 2006, f. 46.

natyrale, Sllovenia hyri në shekullin 21 me rritje negative natyrale.<sup>4</sup>

Tabela 2: Lëvizja natyrale e popullsisë në Kosovë<sup>5</sup>

Viti	Numri i popullsisë (000)	Nataliteti	Mortaliteti	Rritja natyrale	Vdekshmëria e foshnjave
1934	592	37.6	20.6	17.0	161.7
1950	764	46.1	17.0	29.1	141.3
1955	842	43.6	18.2	25.4	164.0
1960	944	44.1	14.2	29.9	132.5
1965	1,075	40.5	10.9	29.6	122.6
1970	1,220	36.5	8.9	27.6	96.3
1975	1,406	35.1	7.1	28.0	80.3
1980	1,553	34.2	5.7	28.5	57.7
1985	1,760	30.6	6.7	23.9	56.1
1987	1,848	30.4	5.6	24.8	50.7
2002	1,985	18.2	2.8	15.4	11.1
2003	2,016	15.9	3.2	12.7	14.5
2004	2,041	17.2	3.1	14.1	11.8
2005	2,070	18.0	3.4	14.6	9.6
2006	2,100	16.3	3.6	12.7	12.0
2007	2,126	15.6	3.1	12.5	11.0

<sup>4</sup> Gjatë viteve të fundit, Republika e Sllovenisë përjetoi një rritje të lehtë të natalitetit: 9.1‰ në vitin 2005, 9.4‰ në vitin 2006, 9.8‰ në vitin 2007, dhe 10.01‰ në vitin 2008, përdërisa mortaliteti stagnoi në nivelet e vendosura nga piramida e popullsisë dhe plakjen e përgjithshme të popullsisë: 9.4‰ në vitin 2005, 9.1‰ në vitin 2006, 9.2‰ në vitin 2007, si dhe 9.1‰ në vitin 2008. Arsyeja e rritjes së natalitetit duhet të gjendet si shoqëruet i rritjes së moshës tek nënat në lindjen e parë, me shkallë të përgjithshme të natalitetit të ultë: 1.21 fëmijë për një nënë në vitin 2001, 1.21 më 2002, 1.2 më 2003, 1.25 më 2004, 1.26 më 2005, 1.31 më 2006, si dhe 1.38 në vitin 2007. [http://www.stat.si/tema\\_demografsko\\_prebivalstvo.asp](http://www.stat.si/tema_demografsko_prebivalstvo.asp) (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<sup>5</sup> Të dhënat për vitin 1934: *Prilozi za izgradjivanje društvenih stavova o planiranju porodice i regulisanju uslova prekida trudnoće* (Beograd, 1968), Shtojca 1, Osvrt na demografski razvitek jugoslovenskog stanovništva, Tabela 3, f.3. Të dhënat për vitet 1950-1987: *Jugoslavija 1918-1988, Statistični godišnjak* (Beograd: Savezni zavod za statistiku, 1989), Tabelat 3-8, Kretanje stanovništva po republikama i pokrajinama, pp. 42-43. Të dhënat për shekullin 21.: ZSK, *Analysis of the Vital Statistics for the Newest Period of Time* [http://www.ks-gov.net/ESK/eng/index.php?option=com\\_docman&task=cat\\_vie&gid=8&Itemid=8](http://www.ks-gov.net/ESK/eng/index.php?option=com_docman&task=cat_vie&gid=8&Itemid=8) (përdorur më 17 Qershor, 2009).



Në Kosovë mortaliteti filloi të bjerë gjatë periudhës së shtetit të parë jugosllav si dhe vazhdoi përgjatë shekullit 20. Në kontrast me situatën në Slloveni, zbritja intensive e shkallës së mortalitetit ishte e shoqëruar me rritje të natalitetit; ky trend anasjelltas ishte veçanërisht evident gjatë dekadës së Jugosllavisë Socialiste. Nataliteti i lartë dhe zvogëlimi i shkallës së mortalitetit mund të vërehet deri në fund të shekullit. Më 2002, nataliteti ra nën 20% për herë të parë, ndërkaq mortaliteti arriti minimumin e 2.8%. Si përmbledhje: marrëdhënia ndërmjet natalitetit dhe mortalitetit në Kosovë në shekullin 20 përjetoi dinamika të veçanta të shoqëruara vazhdimisht me një zhytje të shkallës së mortalitetit, që ra për gati dhe herë në mes të viteve 1934 dhe 2002, dhe nga një zbritje e vogël dhe mbi të gjitha e vonuar e shkallës së natalitetit, e cila është përgjysmuar gjatë periudhës së njëjtë. Gjatë periudhës gati të njëjtë, Sllovenia iu nënshtrua një procesi të ndryshëm: mortaliteti ra për një të tretën, kurse nataliteti për tri herë.<sup>6</sup>

Përderisa gjatë fundit të tranzicionit demografik Sllovenia u ballafaqua me ngecje në shkallën e natalitetit dhe mortalitetit, rritje negative natyrale të popullsisë, zvogëlim në numrin e të rinjve dhe rritje në numrin e njerëzve të vjetër dhe iu desh të shtrojë pyetje për vendosjen e një dialogu të ndër-gjeneratave dhe konceptimin e politikës së migracionit, Kosova, ende në proces të tranzicionit demografik, duhet të ballafaqohet me dilemat e ndryshme, shumica të lidhura me modernizimin e shoqërisë. Në dekadën e parë të shekullit të 21-të, indikatorët e lëvizjes së popullsisë në Kosovë shfaqin ndryshime të theksuara në trendët si: rënie në shkallën e natalitetit, ngecje në shkallët e ulëta ekstreme të mortalitetit, si pasojë, ngecje në rritje natyrale. Sidoqoftë, Republika e Kosovës ende ka shkallën më të lartë të rritjes natyrale dhe të natalitetit në Evropë.<sup>7</sup>

---

<sup>6</sup> Nga pikëpamja e Jugosllavisë, të dy proceset ishin shumë më të balancuara. Ndërmjet viteve 1931 dhe 1987, të dy shkallët u përgjysmuan: ajo e mortalitetit prej 13.8% në 9.2%, dhe ajo e natalitetit prej 33.6% në 15.3% (*Jugosllavia 1918-1988*, 1989, 41, Tabela: Kretanje stanovništva).

<sup>7</sup> Brenda BE-së, Republika e Irlandës është shteti i vetëm me shkallë më të lartë të natalitetit (18.1%). Për më tepër, Irlanda gjithashtu ka një rritje natyrale të ngjashme (12%), përderisa mortaliteti është më i lartë (6.1%)

### **Faktorët e tranzicionit**

Deri në mes të shekullit 20, demografët besuan se tranzicioni demografik evropian ishte i lidhur ngushtë me ndryshimet e jetesës që arritën si rezultat i industrializimit dhe urbanizimit. Studimet bashkëkohore dhe studimet hulumtuese të demografisë dhe të historisë demografike, ndërkaq, vënë në dyshim serioz supozimet e tilla pasi që është vërtetuar shkencërisht se nuk ka lidhje të thjeshtë ndërmjet zhvillimeve shoqërore-ekonomike dhe ndryshimeve demografike. Përveç faktorëve ekonomik, vëmendje e lartë ju kushtua edhe faktorëve të tjerë, si rëndësia e rritur e vlerave që përkrahin individualizmin dhe vetëdijesimin personal, përhapja e konceptit të familjes nukleare duke shikuar fëmijët si marrësit e pastër të mirëqenies së familjes, dhe përhapjes së diturisë, si dhe rritja e përdorimit të kontrceptivëve efikas.<sup>8</sup> Perspektiva historike përbrenda studimeve demografike ende paraqet dyshime rreth rrolit të të gjithë faktorëve të lartpërmendur përderisa ata nuk na ndihmojnë për të shpjeguar pse zbritja në shkallë e mortalitetit – indikator i primar i tranzicionit demografik në territorin e Republikës së Sllovenisë, si dhe tokat historike, si p.sh. Karniola – ndodhi një kohë të gjatë para shfaqjes së faktorëve të lartpërmendur. Për ta kuptuar evolucionin e tranzicionit demografik, duhet të dihen shkaqet fillestare për zbritjen e mortalitetit të popullsisë për të cilën bëhet fjalë.

Në sipërfaqen e sotme të Republikës së Sllovenisë, mortaliteti ra përtej 30% pas përfundimit të luftërave napoleoniane kur austriakët u përforcuan përsëri. Nëse tranzicioni demografik kuptohet si një tranzicion i lëvizjes së popullsisë prej një periudhe kur popullata është e varur nga faktorët e detyruar<sup>9</sup> deri në një periudhë që drejtohet nga

---

se ai në Kosovë; [http://www.stat.si/tema\\_demografsko\\_prebivalstvo.asp](http://www.stat.si/tema_demografsko_prebivalstvo.asp) (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<sup>8</sup> Šircelj, Milivoja. 2006. *Rodnost v Sloveniji od 18. do 21. stoletja*. Ljubljana: Statistični urad Republike Slovenije, f. 30-34.

<sup>9</sup> Sipas Livi Bacci, Massimo, 2005, *Prebivalstvo v zgodovini Evrope* Ljubljana: \*cf., f. 9., faktorët kryesorë të detyruar janë “klima, hapësira, toka, strukturat e

faktorët e lirisë së zgjedhjes<sup>10</sup>, atëherë pjesa e parë e shekullit të 19-të u shoqërua me ndryshime të atilla në territorin slloven: më 1817, sipërfaqja përjetoi krizën e fundit, disa nga faktorët kryesorë të detyruar që ndikuan në lëvizjen e popullatës në regjimin e vjetër.<sup>11</sup> Në atë kohë revolucioni agrar<sup>12</sup> ishte përhapur gjithashtu në të gjithë territorin slloven, gjë që solli dinamika më të mira dhe prodhim për sektorin ekonomik që mbeti me rëndësi të madhe për mbijetesën e popullsisë përgjatë shekullit të 20-të. Për më tepër, në shekullin 19, territori slloven ndaloi së vuajturi nga epidemitë, të cilat kishin ndikim të madh në numrin e popullsisë më tepër se një shekull më parë, me përjashtim të vetëm të epidemisë kolera që shkaktoi rritje në mortalitet në mes të shekullit 19. Ndryshimet kyçe që ndikuan në thellimin e evolucionit të tranzicionit, ishin, gjithashtu, të lidhura me statusin e ri të fshatarësisë (në atë kohë ajo përbënte shumicën e popullatës) si rezultat i heqjes së bujkrobërisë rreth

---

popullsisë, sëmundjet, energjia, ushqimi dhe resurset”, që do të thotë se këta faktorë që janë të rëndësishëm për të gjithë popullsinë, që ndryshojnë vetëm në mënyrë të ngadalshme ose nuk ndryshojnë fare, dhe të cilëve popullata duhet t’u adaptohet në kohë afatgjatë apo afatshkurtër; me fjalë të tjera, këta faktorë që duhet adaptuar dhe bëjnë harmonizimin e rritjes së popullsisë.

<sup>10</sup> Si nxitës dhe ngadalësues të rritjes së popullsisë, faktorët e zgjedhjes ndikojnë më së shumti në ritmin e rritjes së popullsisë. Ato janë “ndryshimet në sjelljen individuale ose kolektive që janë me rëndësi vitale për zhvillimet demografike që lidhen me vendime të papërmbajtura”: martesë, nataliteti i shkaktuar nga faktorë natyralë dhe të qëllimshëm, lëvizshmëria dhe migrimi.

<sup>11</sup> Përgjatë gjithë Evropës Qendrore dhe Perëndimore, periudha 1816-17 ishte e shoqëruar me mbijetesën e fundit të krizës së shkaktuar nga ndryshimet klimatike ngritja në çmime dhe epidemia tifo. Krizat e ardhshme ishin të karakterit lokal edhe pse rezultati i tyre ishte katastrofik (p.sh. kriza e madhe në Irlandë në mes të shekullit 19).

<sup>12</sup> Në tokat Sllovene, revolucioni agrar – i iniciuar më parë nga “fiziokratja” Maria Tereza dhe Jozefi II-të në gjysmën e dytë të shekullit të 18-të, por pa sukses të madh – ishte bazuar në përdorimin intensiv të tokës, gjë që nuk i la më tokat e papunuara, me përdorimin e tokave të reja, me paraqitjen e kulturave të “reja” (patateve, misrit, hikrrave), tokat industriale (fijet e lirit, kërpi) dhe prodhimet tagji (tërfil, jonxhë), në lëvizje prej kulturës së zgjatuar pastore të rritjes së bagëtisë deri në rritje të brendshme të bagëtisë, e cila i mundësoi fertilizatorët natyralë dhe paraqitjen e teknikave të reja agrare.

viteve 1780, si dhe një numër i ndryshimeve të përmbushura nga administrata franceze (gjatë kohës së Provincave Ilire, 1809-1813), si heqja e të gjitha shërbimeve personale të detyruara si shpërblim për një feudal, heqja e shërbimeve të detyrueshme që nuk lidheshin me tokën, gjë që u solli përfitime fshatarëve që nuk posedonin tokë, si dhe heqja e esnafëve, si dhe paraqitja e ndarjes së tokës. Të gjitha këto ndryshime ngritën dallimet e brendshme dhe lëvizjen e fshatarëve. Në tokat sllovene, fillimi i shekullit të 19-të u shoqërua me industrializimin e hershëm si dhe rekonstruktimin e ekonomisë kombëtare; kjo e fundit ishte ndër më të ngadalshmet për t'u zhvilluar në Mbretërinë Austriake; po në të njëjtën kohë u ndërtuan edhe fabrikat e para, anijet e para me avull u lëshuan, u hapën minierat e para si dhe u bë ndërtimi i hekurudhave të para. Për më tepër, periudha 1868/69 ishte jo e parëndësishme pasi që përjetoi përfundimin e një reforme efikase shkollore, kur ndjekja e shkollës fillore u bë e detyrueshme për të gjithë fëmijët pa marrë parasysh gjininë apo strukturën prindërore në statusin shoqëror. Para përfundimit të shekullit 19, territori slloven kishte një përqindje të lartë të popullatës së shkolluar (më shumë se 80% të popullsisë).

Gjatë shekullit të 19-të, ky regjion përjetoi rritje të madhe natyrale të popullsisë falë zbritjes së shkallës së mortalitetit dhe natalitetit të vazhdueshëm të lartë; regjionet individuale, në veçanti ato që shtriheshin përgjatë qendrave të zhvilluara, u mbipopulluan në relacion me resurset në dispozicion, kështu që popullata sllovene filloi të merrte pjesë në migrimet evropiane dhe lëvizjet mërgimtare. Edhe nëse kjo e fundit bëri që të rritet numri i banorëve në administrimin slloven, qendrat komerciale dhe industriale, ku numri i popullsisë u rrit në shkallë më të larta se mesatarja e reflektuar e shkallës së rritjes, rritja aktuale e numrit të popullsisë ishte shumë më e vogël se rritja natyrale.<sup>13</sup> Qëndrimi i autoriteteve drejt emigracionit, që do të thotë largim i popullsisë, ndryshoi në pajtim me rritjen e popullsisë: deri më

---

<sup>13</sup> Karniola shënoi vlerat e rritjes natyrale dhe aktuale si: 7.83% dhe 3.7% respektivisht në mes 1880 dhe 1890, 8.34% dhe 1.8% respektivisht në mes 1890 and 1900, si dhe 9.59% dhe 3.5% respektivisht në mes 1900 dhe 1910 (Žnidaršič Žagar 2000, 111).

1867, emigrantët duhet të merrnin një leje pasi të kishin paguar tarifën e largimit (*Abfahrtsgehd*), pas atij viti ishte e nevojshme për meshkuj që të mbaronin detyrimin ushtarak.<sup>14</sup> Në përgjithësi, austriakët mbanin çuditërisht të dhëna të dobëta<sup>15</sup> rreth emigracionit, gjë që mund të tregojë se emigracioni është përdorur edhe si korrektues brenda shoqërive në pamundësi që të ballafaqohen me rritje të popullsisë. “Për vetëm 60 vjet para Luftës së Parë Botërore, mëmëdheu jonë humbi rreth 280.000 emigrantë, që përbënin 28% të popullsisë së tërë.” (104) Shpërnguljet janë një indikator i rëndësishëm i zhvillimeve të popullsisë, sepse (dhe kurdoherë) ato janë zgjedhëse të gjinisë. Sa i përket gjinisë së imigrantëve slloven para Luftës së Parë Botërore, të dhënat statistikore austriake na lënë në terr; sidoqoftë, “raporti i përafërt mes meshkujve dhe femrave karniolane ishte 2:1 (saktësisht 1.7:1)”.<sup>16</sup> Në periudha dhe mjedise ku martesë është parakusht për jetë seksuale të mashkullit dhe (në veçanti) femrës, mungesa e meshkujve në grupmosha të përshtatshme për martesë lidhet me shkallën e natalitetit. Shpërngulja luan rrol thelbësor në shpërbërjen e rrjeteve tradicionale shoqërore që, në këto lidhje shoqërore, praktikat e jetës tradicionale, të lidhura (gjithashtu) me riprodhim, janë transmetuar në atë kohë, çka në atë kontekst, i bën femrat të jenë grupi çelës.

Në Kosovë, popullsia shënoi një rritje të shpejtë gjatë periudhës së Jugosllavisë Socialiste. Për herë të parë u dyfishua numri për një periudhe kohore prej 30 vjetësh (prej viteve 1930 deri në vitet 1960) për të kaluar një milion për herë të parë në histori, dhe vazhdoi të rritet me shpejtësi në gjysmën e dytë të

---

<sup>14</sup> Kalc, Aleks. 1996. »Ladijske potniške evidence kot vir za zgodovino izseljenstva, s posebnim ozirom na izseljenske sezname tržaškega pristanišča.« In: *Dve domovini*, št. 7, str. 51-69.

<sup>15</sup> “Të varfër çuditërisht” sepse të dhënat kombëtare austriake mund të merren si shembull në krahasim me të dhënat tjera në Evropë, që ishte pohuar shumë herët, në vitin 1899 prej Ferrin Weber, dhe mund të konfirmohet nga kushdo që i përdor të dhënat e ndryshme statistikore si burim hulumtimi. Cf. Kalc 1996.

<sup>16</sup> Žnidaršič Žagar, Sabina. 2000. *Ora et labora – in molči, ženska! Pregled demografije dežele Kranjske in pridobitnosti žensk v desetletjih 1880-1910*. Ljubljana: \*cf., f. 53.

shekullit 20, për t'u bërë dy milionë në fillim të shekullit 21. Për 70 vjet, popullata kosovare u dyfishua dy herë.<sup>17</sup> Në shekullin e fundit, territori slloven, përkundrazi, përjetoi një rritje të ngadalësuar të popullsisë: në pajtim me rindërtimin e të dhënave<sup>18</sup> të mbledhura në regjistrimin e vitit 1931, territori i Republikës së sotme të Sllovenisë ishte shtëpia e 1,266,604 banorëve<sup>19</sup>, ndërkaq në vitin 2008, sipas Zyrës së Statistikave të Republikës së Sllovenisë, popullsia e përgjithshme ishte 2,032,362, që tregon se gjatë 70 viteve të fundit, popullata sllovene është rritur për një shifër të mirë 60%. Rritja e shpejtë e popullatës kosovare ishte e nxitur nga shpërnguljet individuale, gjë që la pasoja të pashlyera në zhvillimet historike të regjionit gjatë shekullit të 20-të.<sup>20</sup> Supozimet dhe hipotezat për evolucionin si dhe pasojat e shpërnguljeve në Kosovë (gjithashtu edhe në Shqipëri si dhe pjesët perëndimore të Maqedonisë të populluara me shqiptarë) janë skajshmërisht kontradiktore. Në shumicën e rasteve, janë burimet serbe që i kushtojnë rëndësi shpërnguljeve në gjysmën e dytë të shekullit 20: Šaranović<sup>21</sup> fokusohet në shpërnguljet e shqiptarëve në Kosovë dhe Maqedoninë Perëndimore pas Luftës së Dytë

<sup>17</sup> Numërimet e rritjes së popullsisë së veçantë varen nga viti bazë; nëse krahasohen për një periudhë të gjatë kohore, rritja e popullsisë Kosovare vërtetohet të jetë edhe më dramatike: sipas analizës së ZSK për një periudhë të gjatë kohore prej 123 vjetëve (nga 1880 deri më 2004) numri i popullsisë kosovare është rritur për 8.5 herë (prej 240,000 në 2,041,000 2banorë); SOK Analysis of the Vital Statistics for the Newest Period of Time 7/2008, f. 5 [http://www.ks-gov.net/ESK/eng/index.php?option=com\\_docman&task=cat\\_view&gid=8&Itemid=8](http://www.ks-gov.net/ESK/eng/index.php?option=com_docman&task=cat_view&gid=8&Itemid=8) (Përdorur më 17 Qershor, 2009).

<sup>18</sup> Gjatë ekzistencës së Mbretërisë Jugosllave, territori slloven ishte i ndarë në dy shtete. Në pajtim me një pjesë të fshehtë nga Traktati i Londrës i nënshkruar nga Mbretëria e Italisë dhe marrëveshjes së trefishtë (Triple Entente) më 1915, Italia aneksoi pjesën perëndimore të territorit slloven më 1918. Sipërfaqja ishte bashkuar mëmëdheut të vet vetëm pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore më 1945.

<sup>19</sup> Melik, Anton. 1963. *Slovenija. Geografski opis*. Ljubljana: Slovenska matica, f. 345 SURS, <http://www.stat.si/pxweb/Dialog/Saveshow.asp> (accessed June 16, 2009).

<sup>20</sup> Shpërnguljet gjithashtu luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Kosovës në periudhat paraprake; cf. Cvijić 1966.

<sup>21</sup> Šaranović, Mihailo, ed. 1981. *Enver hodžina Albanija*. Beograd: Tanjug.

Botërore të nxitur nga tirania e Enver Hoxhës, përderisa Trifunovski<sup>22</sup> “pas disa viteve pune në teren u vërtetua se numri i familjeve të përhapura në Polog (Maqedoni Perëndimore) janë me emigrantë për nga origjina”.<sup>23</sup> Arritja e gjeneratave kryesisht të reja (shumica të gjinisë mashkullore), duke poseduar kapacitet të lartë të asimilimit<sup>24</sup>, pa dyshim që e nxiti rritjen e natalitetit përbrenda komunitetit shqiptar dhe, duke marrë moshën strukturore të popullsisë lokale, kontribuoi në ulje të mortalitetit. Rritja natyrale e popullsisë kosovare duket të jetë e varur nga një numër bashkëkohor i raporteve mes etnive që jetonin në atë regjion; raportet lëvizëse mes numrit të popullsisë shqiptare dhe jo-shqiptare përkrah hipotezën për vitalitetin shumë të madh të shqiptarëve: “nataliteti i lartë i bën që të veçohen pa marrë parasysh nëse jetojnë si shumicë apo si minoritet”.<sup>25</sup> Raporti i numrit mes etnive të ndryshme në Kosovë ka qenë nën influencën e matjeve politike dhe planeve të autoriteteve të kohës, plani i të cilave ishte ndërrimi i strukturës etnike në rajon. Kështu, Mbretëria Jugosllave, pasi që kishte dështuar në tentimin e parë për asimilimin, paraqiti masa të ndryshme për largimin e shqiptarëve nga Kosova dhe Maqedonia Perëndimore. Më 1920, Vasa Čubrilović përpiloi një plan të hollësishëm për dëbimin e tyre në Turqi, e cila ishte në gjendje të vendoste 400,000 njerëz në Rrafshnaltën e Anadollit për kompensim si këmbim. Edhe nëse plani nuk do të mbaronte me sukses, disa matje<sup>26</sup> pohojnë që rreth 100,000 shqiptarë janë dëbuar nga Jugosllavia. Gjatë

---

<sup>22</sup> Trifunovski, Jovan. 1988. *Albansko stanovništvo u Makedoniji*. Beograd: Književne Novine, f. 13-17.

<sup>23</sup> Zupančič, Jernej. 2008. »Albansko vprašanje v luči političnoteritorialne rekonstrukcije Balkana.« In: *Razprave in gradivo*, št. 55, str. 6-49. Ljubljana: Inštitut za narodnostna vprašanja, f. 25 <http://www2.arnes.si/~ljinv16/RIG/RIG%2055/Zupancic.pdf> (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<sup>24</sup> Ibid.

<sup>25</sup> Zupančič, Jernej. 2008. »Albansko vprašanje v luči političnoteritorialne rekonstrukcije Balkana.« In: *Razprave in gradivo*, št. 55, str. 6-49. Ljubljana: Inštitut za narodnostna vprašanja, f. 26 <http://www2.arnes.si/~ljinv16/RIG/RIG%2055/Zupancic.pdf> (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<sup>26</sup> Malcolm, Noel. 2002. *Kosovo: A Short History*. London: Pan Books, f. 286.

Luftës së Dytë Botërore dhe kohës së Shqipërisë së Madhe,<sup>27</sup> popullata serbe që jetonte në viset e okupuara vuante nga prishja e konsiderueshme e kushteve të jetesës. Pas luftës, Jugosllavia socialiste filloi të ndërtojë gradualisht federalizmin kombëtar, një nga qëllimet e të cilës ishte shmangja e rilindjes së konflikteve ndëretnike; sa i përket situatës në Kosovë, u bënë ndryshime thelbësore me reformat kushtetuese më 1974, duke i dhuruar Kosovës, në atë kohë një autonomi provinciale, autonomi të brendshme dhe disa tipare të shtetit. Pas mbarimit të reformave të vitit 1974, Kosova përjetoi jo vetëm formimin e institucioneve kombëtare, por gjithashtu edhe intensifikimin e aspiratave kombëtare të nxitura nga popullata shqiptare. Që nga vitet 1960, kur një industrializim më intensiv ishte parë në rajon, tranzicioni demografik dhe rënia e natalitetit si rezultat ndikuan shumë në jo-shqiptarët, më së shumti tek serbët. Një faktor tjetër që ndikoi në zvogëlimin e natalitetit ishte shpërngulja: në vitet 1960 dhe 1970, ky segment i popullatës e lëshoi vendin kryesisht për shkaqe ekonomike, ndërkaq gjatë viteve 1980 shpërngulja u bë edhe për shkak të arsyeve politike dhe të sigurisë.<sup>28</sup> Komuniteti shqiptar reagoi ndaj reformave socialiste në mënyrë plotësisht tjetër; ai ishte në periudhën që regjistroi rritjen më të madhe të popullsisë si rezultat i qasjes më të mirë të resurseve për mbijetesë, dobësimi i forcave të detyrueshme dhe efektet pozitive të modernizimit gradual, ndonëse selektiv në një masë të madhe.

Si rajon i orientuar kryesisht drejt aktiviteteve bujqësore, Kosova ishte përballur gjithmonë me çështjen e mbipopullimit; edhe sot, ajo shënon një densitet relativisht të lartë të

---

<sup>27</sup> E vendosur pas okupimit Italian më 1941, Shqipëria e Madhe ishte entiteti i parë politik, territori i së cilës përfshinte përafërsisht të gjitha zonat të cilat kishin aspirata për një bashkim politik në një shtet të vetëm (Zupancič 2008).

<sup>28</sup> Viti 1981 shënoi fillimin e revoltave shqiptare. Një moment tjetër historik është viti 1989, kur Qeveria Serbe u hoqi Kosovës dhe Vojvodinës statusin e autonomisë. Eskalimi në konflikte të armëve më 1998/99 u përçoll me intervenimin ndërkombëtar dhe, në vitin 2000, Kosovës iu dha një status special. Së paku për shqiptarët, procesi i ndarjes nga Serbia mbaroi me shpalljen e Deklaratës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2008.



popullsisë.<sup>29</sup> Shpërngulja e kësaj popullate është një nga karakteristikat e këtij rajoni sot, me pasojat e veta, duke ndikuar në të gjitha grupet etnike të rajonit, duke qenë i natyrës ekonomike dhe politike. Në Jugosllavinë Socialiste, shpërngulja e popullsisë shqiptare prej Kosovës ishte kryesisht si rezultat i situatës ekonomike, si dhe i mungesës së punëve të dhëna gjatë shtimit të popullsisë. Kosova përjetoi mos-lidhjen më të madhe ndërmjet mundësive të punësimit dhe numrit të atyre që kërkonin punë në ish-Jugosllavi, gjë që nxiti (kryesisht meshkujt) të praktikojnë shpërnguljen ekonomike dhe, si rezultat i kushteve të mprehta të jetesës të shkaktuara nga mbipopullimi, ruajtën forcën tradicionale të familjeve të përhapura.<sup>30</sup> Ishin këto strategjitë që përdorshin me kriza të popullsisë dhe që penguan modernizimin më efikas të shoqërisë si një nga elementet kryesore të tranzicionit demografik. Në të shumtën e rasteve, sipas interpretimeve serbe, nataliteti i lartë ishte keqpërdorur si një instrument për t'i përmbushur qëllimet e politikës kombëtare shqiptare. Në këtë kuptim, është e rëndësishme që Kosova nuk ishte këmbëngulëse për pjesëmarrje në planifikimin e kampanjës për vendosjen e familjeve nëpër Jugosllavi gjatë viteve të fundit të 1960-tave.<sup>31</sup>

---

<sup>29</sup> Me një densitet të popullsisë me 200 banorë për një kilometër katror, Republika e Kosovës është një nga vendet me densitetin më të madh të popullsisë në Evropë; sipas të dhënave për vitin 2008, Republika e Sllovenisë shënoi një densitet prej 100 banorëve/km<sup>2</sup>. Vendi më i populluar i Evropës është Holanda me (484 banorë/km<sup>2</sup>), ndërkaq densiteti në Britaninë e Madhe është 250 banorë/km<sup>2</sup> (*Slovenija v številkah* 2008, 74-75).

<sup>30</sup> Është veçanti e mjedisit shqiptar që nuk u mor me krizat maltusiane të mbipopullimit dhe frenimit të natalitetit, rritja e banorëve me moshë martesore apo përdorimi i mënyrave të tjera me qëllim që të limitohet riprodhimi i popullsisë. Në të kundërtën, kjo e forcoi më shumë strategjinë e mbijetesës në familjet ekzistuese të përhapura dhe grupet nëpër klane.

<sup>31</sup> Qëllimi i kampanjës ishte të "humanizojë" reproduktimin e popullatës jugosllave, të zhdukë plotësisht abortin ilegal, dhe t'u sigurojë çifteve të martuara qasje legale dhe të mbikëqyrur për kontraceptivët efikas dhe abortimin mjekësor si dhe të paraqesë principin se është e drejtë njerëzore që çiftet e martuara të planifikojnë numrin e fëmijëve dhe shteti të jetë përgjegjës për sigurimin e këtyre shërbimeve. Ideja për këtë kampanjë e ka

Edhe nëse është karakteristikë e fazës fillestare të tranzicionit demografik, zbritja në mortalitet nuk rezulton në ngritje të drejtpërdrejtë të natalitetit pasi që “prindërit nuk pritët ta planifikojnë numrin e fëmijëve të lindur, por të atyre të rritur”.<sup>32</sup> Kur ndodh zbritja e natalitetit si një fazë tjetër e tranzicionit demografik, faktorë të tjerë, si rritja e shanseve për mbijetesë të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, luan rrol më të rëndësishëm se sa rënia e përgjithshme e shkallës së mortalitetit. Mortaliteti i foshnjave si dhe nataliteti janë procese të ndërlydhura; duke u gërshetuar gjatë zhvillimit, rritja e mortalitetit të foshnjës së paralindur dhe të paslindur rezulton në shtatzëni të ardhshme më shpejt, duke shkaktuar shkurtimin e intervaleve ndër-gjenetike, ndërkaq numri më i madh i fëmijëve të mbijetuar rrit kohën dhe resurset materiale të investuara në përkujdesjen dhe edukimin e tyre, gjë që rrit shansin e mbijetesës.<sup>33</sup> Në territorin e sotëm të Republikës së Sllovenisë, mortaliteti i foshnjave filloi të bjerë në gjysmën e dytë të shekullit 19-të prej 220‰ në 170‰ në fillim të shekullit 20, kur të dhënat e para statistikore panë rënien e parë dhe konstante të natalitetit. Përgjatë shekullit, ajo u zvogëlua në ritëm të lartë, kështu që në fund të shekullit Republika e Sllovenisë shënoi një nga shkallët më të ulëta në botë të mortalitetit të foshnjave.<sup>34</sup> Sidoqoftë, ky proces nuk u zhvillua

---

originën në Slloveni, ndërkaq projekti është lëshuar në mbikëqyrje ideologjike të Vida Tomšič, një personalitet me influencë të madhe politike në Jugosllavinë e pas-luftës (pa e përmendur Slloveninë). Suksesi i parë i madh erdhi në vitin 1968, kur Jugosllavia adoptoi Rezolutën mbi Planifikimin e Familjes duke obliguar republikat që ta paraqesin këtë pjesë në ligjet e tyre të brendshme dhe të zhvillojnë infrastrukturën e nevojshme, duke ulejuar atyre autonomi të plotë në vendosjen e ritmit dhe zgjatjes së implementimit. Pas një reforme kushtetuese të vitit 1974, artikujt që nxitën riprodhimin si të drejtë njerëzore, ishin përfshirë në kushtetutën e disa republikave, siç është Sllovenia.

<sup>32</sup> Šircelj, Milivoja. 2006. *Rodnost v Sloveniji od 18. do 21. stoletja*. Ljubljana: Statistični urad Republike Slovenije, f. 96.

<sup>33</sup> Livi Bacci, Massimo. 2005. *Prebivalstvo v zgodovini Evrope*. Ljubljana: \*cf., f.183.

<sup>34</sup> Në Slloveni, mortaliteti i foshnjave filloi të zbresë shpejt pas Luftës së Parë Botërore. Në vitin 1913 ishte 170‰, më 1960 ishte 35.8‰, më 1985 13.1‰, më 1991 8‰, më 1999 4.5‰, më 2006 3.5‰, dhe në vitin 2005 ishte 4.5‰,

vetëm në një drejtim: i shoqëruar me një recesion ekonomik, gjatë viteve 1970 përjetuan një rritje të konsiderueshme në mortalitetin e foshnjave (duke u rritur mbi 250%) veçanërisht në rajonin agrar të Prekomurjes, ku një proporcion i madh i popullsisë punonte si punëtorë fizikë në ferma, ku femra dhe meshkuj së bashku duhet të mësoheshin me shpërnguljen e punëtorëve sezonalë.<sup>35,36</sup> Shkalla e mortalitetit të foshnjave varej gjithashtu nga faktorët shoqërorë, të cilët janë të lidhur ngushtë me faktorë socio-ekonomikë, me urbanizimin intensiv, industrializimin dhe profesionalizimin e femrave (nënave), duke luajtur rol të rëndësishëm. Ishte kjo e fundit që u vërtetua kritike në fazën fillestare; kështu, ky observim i praktikuar gjithashtu për sllovenët ose, më saktësisht, qytetet karnoliane, siç është qyteti Lubjanës: “Arsyeja kryesore e mortalitetit të lartë tek foshnjat në qytete, është ushqimi i dobët /.../ furnizimi me qumësht të kualitetit të dobët, ushqyerja nëpërmjet tubave që s’janë prej gome, është e nevojshme kur ka mungesë të mëndeshave; edhe me përkujdesje të duhur, shkalla e foshnjave të vdekura gjatë kohës së verës rritet gjithnjë kur nëna punon”.<sup>37</sup>

Vdekja e foshnjave lidhet ngushtë më kohën dhe resurset materiale “të investuara” në përkujdesjen e fëmijëve, edukimin, i cili ka qenë kryesisht preokupim i nënave në shumicën e kulturave. “Në përgjithësi, mund të supozohet se deri në arritjen e epokës bakteriale, niveli i dijenisë nuk e lejoi nivelin e vdekjes tek foshnjat të bjerë nën 150% - me përjashtim të kushteve ekstreme shoqërore dhe kushteve mjedisore”.<sup>38</sup> Deri në kohën moderne, faktorët kryesorë ishin koha e lirë e nënave

---

gjë që e bën Slloveninë një nga shtetet më të suksesshme në këtë aspekt. SURS, <http://www.stat.si/pxweb/Dialog/Saveshoë.asp> (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<sup>35</sup> Šircelj, Milivoja. 2006. *Rodnost v Sloveniji od 18. do 21. stoletja*. Ljubljana: Statistični urad Republike Slovenije, f. 96-97.

<sup>36</sup> Melik, Anton. 1963. *Slovenija. Geografski opis*. Ljubljana: Slovenska matica, f. 344.

<sup>37</sup> Ferrin Weber, Adna. 1965. *The Growth of Cities in the Nineteenth Century. A Study in Statistics*. New York: Cornell University Press, f. 361.

<sup>38</sup> Livi Bacci, Massimo. 2005. *Prebivalstvo v zgodovini Evrope*. Ljubljana: \*cf., f. 185.

dhe ushqimi me anë të gjirit; në përgjithësi, paraqitja dhe shpërndarja e pikëpamjeve iluminante nëpër maternitetin në Evropë, solli gjithashtu ri-paraqitjen e gji-dhënies së hershme të rregullt. Ndërsa në shekullin 19 gji-dhënia mori një drejtim tjetër të pavarur nga praktikat kulturore lokale, rëndësia e traditave kulturore dhe lokale ishte në rënie, kurse pjesëmarrja e femrave në tregun kapitalist të punës ishte në ngritje. Të dhënat për vendbanimet sllovene të Karnolisë nga fundi i shekullit të 19-të tregojnë që mjediset bujqësore, sa i përket mënyrës së jetesës, dhe tradicionale, ku femrat fitonin të ardhurat duke punuar në shtëpi ishin më të populluara me foshnje se sa qytetet dhe qendrat industriale, ku femrat ishin pjesë e tregut të punës të paguara jashtë shtëpisë.<sup>39</sup> Në këtë të fundit, mënyra se si të kombinohen detyrat amësore dhe mirëmbajtja shtëpiake me atë profesionale parashtrojnë një problem serioz tek nënat deri në stabilizimin e situatës në Jugosllavinë Socialiste.<sup>40</sup> Një tjetër faktor, tek zvogëlimi i shkallës së vdekshmërisë së foshnjave, ishte paraqitja graduale e vaksinave parandaluese kundër sëmundjeve infektive të fëmijëve; pas epidemisë së lisë, vaksinimi i detyrueshëm kundër kësaj u paraqit më 1921, kundër fruthit të keq më 1932, difterisë më 1930, tetanosit më 1951, kollit të mirë dhe paralizës së fëmijëve më 1957, fruthit më 1968, shytave dhe rubeolës më 1972 për femrat dhe më 1991 për meshkujt.<sup>41</sup>

Në Kosovë, zvogëlimi i shkallës së mortalitetit ka rezultuar si një iniciator i rëndësishëm në zvogëlimin e natalitetit. Lidhja

---

<sup>39</sup> Në vitin 1896, shkallët e vdekjes tek foshnjat 0-9 vjeç në disa vende sllovene ishin: qyteti Lubjanës 200‰, rrethina e Lubjanës 216‰, rajoni kryesisht agrar i Črnomelj 125‰ 125‰ (vlera më e ulët në Karnoli), përderisa shkalla mortalitetit të foshnjave në Karnoli ishte rreth 169 ‰ (Žnidaršič Žagar 2000, 94).

<sup>40</sup> Në Slloveninë e mes luftërave, ishte shumë më e zakonshme për nënat e klasës punëtore se sa atyre të shoqërisë së pasur që të kujdesen për fëmijët e tyre në mënyrë intensive dhe t'i ushqenin me anë të gjirit; jo befasisht, vdekshmëria e madhe e foshnjave të para-lindura dhe posa-lindura ishte e lidhur ngushtë me kujdesin intensiv dhe të ushqyerit me anë të gjirit. (Žnidaršič Žagar 2008)

<sup>41</sup> Šircelj, Milivoja. 2006. *Rodnost v Sloveniji od 18. do 21. stoletja*. Ljubljana: Statistični urad Republike Slovenije, f. 99.

midis këtyre dy trendëve nuk është plotësisht e qartë, veçanërisht kur është fjala për çështje primare.

Në Kosovë, nataliteti filloi të bjerë vazhdimisht atëherë kur mortaliteti i foshnjave ra nën vlerën 50%. Sipas të dhënave të UNMIK-ut <sup>42</sup>, periudha kthesë ishin vitet 1989/90, kur vdekshmëria e foshnjave papritmas u përgjysmua prej 51.2% më 1989 në 34.4% më 1990. Në dekadën e fundit të shekullit të 20-të, vazhdoi të bjerë deri sa arriti në nivelin 10% në fillim të shekullit 21 (2005). Kjo zbritje përbën një nga proceset më dramatike në lëvizjen e popullsisë kosovare gjatë dekadës së fundit; nëse viti 1934 merret si vit bazë i krahasimit tonë, atëherë mortaliteti i foshnjave ra deri në 15 herë deri në fillimin e shekullit 21, duke u zbritur nga 161% në vitin 1934 deri më 11% në 2007. Për shkak të informatave të pamjaftueshme të gjendjes në Kosovë, është e vështirë të shpjegohet një zbritje drastike si ajo që u përjetua gjatë periudhës së tensioneve më të rënda politike. Megjithatë, mund të propozohen dy supozime: një situatë e tillë është çështje e të dhënave jo-adekuate të grumbulluara për vdekjen e foshnjave e para dhe posa-lindura si pasojë e kushteve të pafavorshme politike apo janë ndërrimet thelbësore në kujdesin e foshnjave të para dhe posa-lindura, gjë që rriti shanset e mbijetesës së foshnjave. Dhënë faktin që shkallët e ulëta të mortalitetit të foshnjave janë shënuar gjithashtu në shekullin 21, arsyetohet fakti në zgjedhjen e dytë: që në fillim e shekullit të ri, Kosova iu nënshtrua ndryshimeve radikale në investimin e foshnjave të porsalindura dhe kujdesit të tyre, gjë që përmirësoi mundësitë e mbijetesës së tyre. Supozimi mund të plotësohet me sugjerimin që rritja e kujdesit për foshnjat e posa-lindura është shoqëruar me një zbritje në shkallët e natalitetit; numri më i vogël i foshnjave të porsalindura nënkupton një përkujdesje më të madhe të fëmijëve tjerë si dhe në ngritjen e mundësive të mbijetesës së foshnjave. Supozimi jonë se zbritja e shkallës së vdekshmërisë së foshnjave para dhe posa-lindura (edhe) në Kosovë është ngushtë e lidhur më një kujdes të shtuar dhe më të mirë

---

<sup>42</sup> <http://enrin.grida.no/htmls/kosovo/SoE/popullat.htm>, Diagram 3 përdorur më 20 Qershor, 2009.

konfirmohet edhe nga të dhënat e ZSK-së<sup>43</sup>, sipas së cilës shumica e foshnjave të vdekura (94.5%) ishin nën dy muaj, një e tretat e të cilave (36%) ishin fëmijët e parë, shumica (61.2%) të lindura nga nëna të moshës së re, të moshave njëzet deri në njëzet e nëntë. <sup>44</sup> Natyrisht, është e pamundur të dihet renditja e saktë e proceseve: nëse zbritja e natalitetit e nxitur nga kryengritjet politike çoi deri tek përmirësimin e kujdesit të foshnjave apo nëse zbritja në shkallën e mortalitetit tek fëmijët çoj tek një zbritje e shkallës së natalitetit. Falë natyrës së përafërt të dy trendëve, është më e arsyeshme të përkrahet alternativa e parë, sipas së cilës nataliteti më i ultë mundëson përkujdesjen më të mirë të fëmijëve dhe, si pasojë, e forcon trendin e uljes së natalitetit (së paku) duke zgjatuar intervalet midis gjeneratave.

Faktorët që e rrisin dukshëm mundësinë e mbijetesës së foshnjave janë pjesë e faktorëve të modernizimit: përhapja dhe disponimi i njohurisë dhe teknologjisë. Hulumtimi i udhëhequr nga Elizabeth Horman në verë të vitit 1999 me 900 femra në Kosovë, tregon se femrat nuk janë këmbëngulëse për t'i dhënë ushqim të gjirit fëmijëve, si pasojë e mungesës së njohurisë së udhëzimeve dhe gjetjeve të fundit shkencore. Rezultatet mbi të ushqyerit me anë të gjirit në Kosovë – një mjedis ku i kushtohet rëndësi e veçantë vetive, tipareve, marrëdhënieve dhe praktikave tradicionale – janë të çuditshme dhe plotësisht të kundërta me situatën në Slloveni ku, siç u cek më lartë, kishte një lidhje të ngushtë me orientimin tradicional të mjedisit, përhapjes së mirë të ushqyerit me anë të gjirit dhe, si rezultat, forcimi në shëndetin e foshnjave.

“Kosova është një mjedis ku të ushqyerit e jashtëzakonshëm me anë të gjirit ishte pjesë e praktikuar dhe e përkrahur shumë nga kultura tradicionale. Kjo është ende e vërtetë në masë të madhe, por të ushqyerit me anë të gjirit, sidomos në muajt e

---

<sup>43</sup> ZSK *Analysis of the Vital Statistic, June 2008*, 32.

<sup>44</sup> Do të ishte interesante të vrojtohet se si, në periudhë kohore të njëjtë, mortaliteti i foshnjave ra në raport me moshën e nënave dhe atë që grupet e nënave e shënuan si zbritjen më të madhe në vdekshmërinë e foshnjave. Rezultatet do të na ndihmonin ta kuptonim procesin dhe arsyet e kësaj zbritjeje.

parë, është një përjashtim më tepër se një rregull. Ushqimi shtesë me çaj, uji i ëmbël dhe formula për foshnjat ka filluar në spital gjatë 24 orëve të para të jetës. Ushqimi plotësues fillon shumë herët dhe shpesh nuk përfiton nga ushqimi famëkeq i gjendur në mjedisin lokal. Rishtazi formula për foshnjat ka filluar të përdoret në masë të madhe. Praktika e të ushqyerit me anë të gjirit në Kosovë nuk paraqet standardet ndërkombëtare për ushqim të jashtëzakonshëm me anë të gjirit për rreth gjashtë muaj si dhe ushqim me anë të gjirit të vazhdueshëm kohor, adekuat dhe i përshtatshëm si ushqim plotësues për moshë deri në 2 vjeç ose më tepër.<sup>45</sup>

Në shumë organizata joqeveritare ndërkombëtare dhe agjenci të Kombeve të Bashkuara, të punësuarit shpesh nuk janë të vetëdijshëm dhe nuk i njohin rekomandimet dhe politikat e punëdhënësve të tyre lidhur me praktikën e të ushqyerit me anë të gjirit. Interesi dhe vetëdija për rolin që të ushqyerit me anë të gjirit e ka në pediatri, në shëndetin primar dhe publik janë shumë të vegjël. Edhe tek personat me edukim të lartë për kujdesin shëndetësor, të ushqyerit me anë të gjirit mund të shikohet si një mënyrë joshkëncore, negative dhe e ngjyrosur me emocione. Kjo përbën pengesa të mëdha në mënyrën e implementimit.

Nëse të ushqyerit me anë të gjirit mbrohet, përkrahet dhe nxitet sikur që është e parashikuar nga një seri e dokumenteve politike të lëshuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe agjencitë e OKB-së, nevojitet një qasje e përgjithshme e

---

<sup>45</sup> Sipas Horman-it, 11% e femrave nuk e kanë praktikuar të ushqyerit me anë të gjirit tek foshnjat, më pak se 35% e praktikuan atë për më pak se gjashtë muajt e parë, vetëm 12.2% janë veçanërisht të ushqyer me anë të gjirit për katër muajt e parë, 25% e femrave nuk ja fillojnë të ushqyerit me anë të gjirit në ditën e parë të lindjes së foshnjës së tyre, 68% e foshnjave janë të ushqyera nga qumështi i lopës para moshës gjashtë mujore, 97% janë të ushqyer me qaj të zi para moshës një vjeçare, 11% e foshnjave janë të ushqyer shtesë me një kombinim të biskotave dhe qumështit të lopës para moshës dy muajsh dhe 42% para moshës gjashtë muajsh, vetëm 43% e foshnjave janë të ushqyera me fruta dhe perime në moshën prej gjashtë deri në tetëmbëdhjetë, vetëm 39% janë të ushqyer me mish, vezë dhe peshk, si dhe 10.7% të fëmijëve më të ri se pesë vjeç tregojnë shenja të paushqyeshmërisë kronike.

integruar. Strategjia bazë për mbijetesën e fëmijëve e GOBI-FFF është një model i duhur që i përgjithëson disa strategji të ruajtjes së jetës - mbikëqyrjen e rritjes, marrjen e ushqimit të thatë, të ushqyerit me anë të gjirit, imunizimi, planifikimi i familjes, shkollimi i femrës si dhe ndarja e ushqimit. Vetëm të ushqyerit me anë të gjirit nuk është zgjidhja; pa përfilljen e duhur të saj nuk funksionon asnjë strategji tjetër".<sup>46</sup>

Të ushqyerit me gji në mënyrë jo-intensive është padyshim një faktor i rëndësishëm për zvogëlimin e intervaleve ndër-gjenetike, e shoqëruar me mos përdorimin e kontrceptivëve dhe rritjen e natalitetit,<sup>47</sup> ndërsa të ushqyerit jo i rregullt i foshnjave të porsalindura dhe foshnjave të tjera, ka një ndikim direkt në rritjen e mortalitetit të foshnjave. Praktikrat tradicionale rreth të ushqyerit me anë të gjirit dhe të ushqyerit, që janë të përhapura mirë në Kosovë, siç konstatoi Horman më 1999, janë pa dyshim një faktor që nuk do të mund të shfaqte ndikim të madh në uljen e shkallës së mortalitetit të foshnjave një dekadë para hulumtimit të Horman-it. Duket se modernizimi në këtë fushe është duke luhatur dhe ka ngecur prapa, pasi që praktikrat tipike tradicionale të modelit për natalitetin e humbur ishin ende dominuese.

Gjatë socializmit, modernizimi ishte padyshim i suksesshëm në fushën e kujdesit për femrat/gratë dhe fëmijët në moshë të re. Proporcioni i femrave kosovare që lindën në institucionet mjekësore dhe që u është dhënë ndihma mjekësore, u rrit

---

<sup>46</sup> Horman, Elizabeth. 1999. »Report on Breastfeeding Consultancy in Kosovo. September-December 1999, f. 11. <http://www.euro.who.int/Document/Nut/infantkosovo.pdf>, (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<sup>47</sup> Në Jugosllavinë socialiste, Kosova shënoi një përdorim shumë të ultë të kontrceptivëve si dhe shkallën më të ultë të njohurisë së femrave me së paku metodat e një kontrceptivi. Sipas të dhënave të mbledhura nga Qendra për hulumtime demografike, më 1970 vetëm 39% e femrave në Kosovë kishin njohuri me së paku për një kontrceptivë, ndërkaq në Slloveni kjo shifër ishte më e madhe se 90%. Në periudhën e njëjtë, vetëm 15% e femrave të martuara në Kosovë përdornin kontrceptivë, ndërkaq në Slloveni kjo shkallë ishte mbi 60% (*Socialni aspekti planiranja porodice u Jugoslaviji* 1974, 108, 110, Tabela 8, Tabela 10). Fatkeqësisht, ishim të pamundur të gjejmë të dhëna rreth përdorimit të kontrceptivëve sot në Kosovë.



gradualisht edhe pse në një shkallë skajshmërisht të ulët në krahasim me gjithë shtetin (Jugosllavinë). Sipas të dhënave të Institutit Shtetëror për Ndhimë Shëndetësore në Beograd, më 1961 lindën me ndihmën mjekësore më shumë se gjysma (saktësisht, 53.6%) e femrave jugosllave, ndërsa në Kosovë numri i tyre ishte 17% (më pak se një e gjashta); një dekadë më vonë, proporcioni i Kosovës gati u dyfishua: 31%, por ende mbeti më i vogël se ai në Jugosllavi, që ishte 73.4% (*Socialni aspekti planiranjë porodice u Jugosllaviji 1974*, 103, Tabela 2).<sup>48</sup> Arsyeja për një proporcion kaq të vogël të fëmijëve të lindur me ndihmën mjekësore në institucione profesionale qëndron pa dyshim në mungesën e institucioneve mjekësore dhe të stafit.<sup>49</sup> Herët në vitet 1970, Kosova ishte rajoni me numrin më të madh të femrave dhe me numrin më të vogël të institucioneve gjinekologjike në Jugosllavi.<sup>50</sup> Sot, 93.7% e të gjitha lindjeve në

---

<sup>48</sup> Në vitet 1961 dhe 1971, proporcioni më i madh i femrave që lindën me ndihmën mjekësore u shënuar në Slloveni (98.4% dhe 99% respektivisht). Në territorin slloven, “institucionalizimi” gradual i lindjeve filloi në fillim të shekullit 20; në fund të viteve 1930, më tepër se 80% të porsalindurve në Ljublanë ishin të lindur në spitale të lindjes, ndërkaq në kufijtë e territorit slloven, femrat kishin nevojë për të lindur në shtëpi me ose pa ndihmën profesionale. Sugjerimi i femrave që lindin në spitale të lindjes ishte në rritje për arsye të ndryshme: për arsye se numri i asistenteve të certifikuar ishte në zbritje konstante, sepse ndihma mjekësore në shtëpi nga mjeku ishte shumë e shtrenjtë për shumicën e femrave, sepse spitale të lindjes u shndërruan në qendra ku lindja ishte shumë më e sigurt për nënat dhe foshnjat. Në gjysmën e dytë të shekullit 20, lindjet me ndihmën mjekësore profesionale u inkurajuan me të madhe dhe u pranuan si një standard shoqëror (Žnidaršič Žagar 2008; Rožman 2004).

<sup>49</sup> Shkaqet e kësaj mungese të ngjarjes së vërtetë në Kosovë. Në Slloveni, ndërtimi i infrastrukturës për nevojat specifike të femrave ishte një nga prioritetet e lëvizjes feministe që nga Mbretëria e Jugosllavisë; femrat ishin të organizuara që të kërkojnë me këmbëngulësi që shteti tyre të punojë edhe për mirëqenien e tyre. Femrat kontribuan vetë për mirëqenien e tyre përmes punës vullnetare, kontributit material etj. Në Kosovë, mungesa e lëvizjeve feministe u karakterizua me një karakteristikë, që e bënte Kosovën si vendin më të pazhvilluar në shekullin 20 në rajon.

<sup>50</sup> Në vitin 1971, një spital gjinekologjik apo një qendër këshilluese në Kosovë trajtoi më shumë se 9000 femra në periudhën e natalitetit (ky raport ishte tri herë më i mirë në Slloveni); kushtet më të këqija ishin vetëm në “Serbinë e ngushtë”, duke pasur një raport prej 11000 femrave të trajtuara për institucion. Pa nevojë të ceket, më 1971 Kosova kishte indikatorë jo të

Kosovë kryhet në institucionet mjekësore, prej tyre 99.6% me ndihmë mjekësore.<sup>51</sup> Sipas të dhënave të SZK-së për vitin 2007, në shumicën e komunave kosovare, foshnjat ishin dërguar në salla të lindjes ose qendra mjekësore, ndërsa vetëm pesë komuna shënuan vlera të larta të lindjeve jashtë institucioneve mjekësore, duke u sjellë prej 8% deri në 30% të të gjitha lindjeve në komunën e caktuar. Megjithatë shumica e tyre ishin më ndihmë mjekësore.<sup>52</sup>

Sa i përket lindjeve të frytit të vdekur, të dhënat e ZSK-së tregojnë se në dekadën e parë të shekullit 21 vlera ka qëndruar stabil (më pakë se 10‰) nëse krahasohet me atë të lindjeve të gjalla.<sup>53</sup> Sllovenia shënoi shkallë më të ulët: në vitin 2000, p.sh., 3.7‰ e të gjitha lindjeve ishte me fryt të vdekur; vlerat u ulën më poshtë se 10‰ rreth viteve të 1960.<sup>54</sup> Kosova dhe Sllovenia kanë ndërvlerësi të ngjashme: niveli i lindjeve të frytit të vdekur rritet njëjtë me moshën e nënave, si dhe me një grup të veçantë të nënave të reja që gjithashtu kanë shënuar numër të lartë të lindjeve të frytit të vdekur. Në të dy vendet mosha 40 vjeçare vërtetoi të jetë një kufi: pas asaj moshe, shkalla e lindjeve me fryt të vdekur është dukshëm më e madhe se në grupmoshat

---

mirë të pacientëve të një personeli: një mjek duhej të mjekonte gati 4000 pacientë (ndërkaq 3000 në Slloveni), përderisa një infermiere duhej të kujdesej për gati 1000 pacientë në Kosovë (dhe 500 në Slloveni). Për më tepër, Kosova shënoi numrin më të ulët të gjinekologëve të specializuar: në vitin 1971 ishin vetëm 19, shifër që rezultoi në trajtimin e 18,724 femrave të trajtuara nga një gjinekolog në periudhën e natalitetit (*Socialni aspekti planiranja porodice* 1974, 104-106, Tabela 3, Tabela 5, Tabela 6).

<sup>51</sup> ZSK *Statistics of Births in Kosovo, 7/2008*, Tabela 1.2.

<sup>52</sup> Në vitin 2007, komunat që shënuan numrin më të madh të lindjeve jashtë institucioneve mjekësore ishin: Dragashi (25.6%), Kaçaniku (37.6%), Klina (14.9%), Rahoveci (21.1%) dhe Malisheva (18.7%). Me një mesatare të lindjeve të frytit të vdekur në Kosovë prej 8‰ për vitin 2007, disa nga komunat e sipër përmendura kishin një mesatare të lindjeve të frytit të vdekur edhe më të madhe: Kaçanik dhe Klinë (9.1‰), Rahovec (12.6‰) (SOK, *Statistics of Births in Kosovo, 7/2008*, Tabela 1.9).

<sup>53</sup> Në vitet 2004 dhe 2007 u regjistruan këto shkallë të lindjeve të frytit të vdekur: 5.3‰ dhe 8.5‰ respektivisht ((SOK, *Analysis of the Vital Statistics for the Neëst Period of Time, 7/2008*, 23; SOK, *Statistics of Births in Kosovo, 7/2008*, 19, Tabela 1.9).

<sup>54</sup> <http://www.stat.si/doc/pub/rr798-2003/5/T05-02-01.htm> përdorur më 20 Qershor, 2009.

më të reja.<sup>55</sup> Karakteristikë vetëm për Kosovën është numri i lartë i lindjeve me fytyrë të vdekur tek lindjet e para. Në vitin 2007 u shënuan këto vlera: 15.2%<sup>o</sup> prej të gjithë fëmijëve të parë, të cilët janë grupi më i madh i të porsalindurve, 3.3%<sup>o</sup> prej të gjithë fëmijëve të dytë, 3.4%<sup>o</sup> prej të gjithë fëmijëve të tretë, dhe 20%<sup>o</sup> prej të katërve, e cila është shkalla e dytë më e madhe, sigurisht e lidhur me moshën e nënave.<sup>56</sup> Duke gjykuar nga të dhënat, duket e arsyeshme të thuhet se sa i përket çështjes së mortalitetit të foshnjave, jetët e fëmijëve të parë të lindur janë më të rrezikuara nga të porsalindurit; për ta gjetur arsyen duhet të hetohet hollësisht dhe të merren parasysh shumë faktorë, përfshirë këtu edhe edukimin e nënave dhënë faktin që praktikata joadekuata tradicionale janë të përcjella nëpër gjenerata si dhe ndikimi i moshës së nënës (saktësisht, moshë shumë e re dhe papjekuria). Për më tepër, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet hulumtimeve në lindjet e shumta jashtëmartesore të paralindjeve, siç tregojnë të dhënat shumica e martesave ndodhin para plotësimit të lidhjes seksuale, por vetëm pasi që mashkulli të ketë “vërtetuar” fertilitetin e femrës. Rëndësia e kapacitetit të fertilitetit tek femrat për krijimin dhe ekzistencën e martesave mund të vërehet edhe tek të dhënat

<sup>55</sup> Në vitin 2001 kur shkalla e lindjeve të frytit të vdekur ishte 4.9%<sup>o</sup> në raport me të gjitha lindjet e gjalla, në Slloveni u shënuan këto shkallë sipas moshës: 9.1%<sup>o</sup> tek nënat e moshave 15-19, 4.3%<sup>o</sup> tek moshat 20-24, 4.7%<sup>o</sup> tek 25-29, 3.8%<sup>o</sup> tek 30-34, 7.3%<sup>o</sup> tek 35-40, si dhe 18.2%<sup>o</sup> tek nënat e moshave mbi 40 vjeç <http://www.stat.si/doc/pub/rr798-2003/5/T05-07-01.htm>, (përdorur më 20 Qershor, 2009). Në mënyrë që të kuptohet ndikimi i moshës së nënës tek lindjet e frytit të vdekur, është e rëndësishë jetësore të krijohet një lidhje e shkallëve të lindjeve të frytit të vdekur në raport me të gjitha lindjet e gjalla tek një grupmoshë e caktuar e nënave. Një statistikë e tillë, gjithashtu tregon se shkalla e lindjeve të frytit të vdekur rritet në proporcion me moshën e nënës gjatë lindjes. Në vitin 2007 u shënuan këto shkallë: 4.2%<sup>o</sup> e nënave të moshës deri në 19 vjeç, 5.9%<sup>o</sup> tek 20-24 vjeçarët, 6.8%<sup>o</sup> tek 25-29, 11.6%<sup>o</sup> tek 30-34, 10.9%<sup>o</sup> tek 35-39, 24%<sup>o</sup> tek 40-44, si dhe 32.8%<sup>o</sup> tek nënat e grupmoshave mbi 45 vjeç (SOK, *Statistics of Births in Kosovo*, 7/2007, Tabela 1.15 and Tabela 1.22).

<sup>56</sup> Dhënë vlerën e ulët të natalitetit në Slloveni, shumica e lindjeve të frytit të vdekur ndodhin tek lindjet e para; prej të gjitha lindjeve të para, 9.9%<sup>o</sup> janë lindje të frytit të vdekur [http://www.stat.si/letopis/1992/1992\\_04.pdf](http://www.stat.si/letopis/1992/1992_04.pdf), Table 4-14 (përdorur më 20 Qershor, 2009). ZSK, *Statistics of Births in Kosovo*, June 2007, Tabela 1.22, Tabela 1.14.

mbi divorcin, që është i shpeshtë në grupmoshat e reja, në grupe ku martesë ka qenë jetëshkurtër.<sup>57</sup> Për faktin që fëmijët janë një nga arsyet kryesore për kualitetin dhe ekzistencën e martesës, është konfirmuar edhe nga puna në terren e bërë tek nënat në Kosovë.<sup>58</sup>

Elemente tjera tipike të modernizimit janë të zbuluara dobët: nuk ka informata mbi mënyrën e planifikimit të familjes dhe kontrollimin e lindjes (p.sh. përdorimin e kontraceptivëve, frekuencën e abortimit legal etj.). Për më tepër, indikatorët që vërtetuan të jenë të lidhur ngushtë me tranzicionin demografik në Slloveni, si shkollimi i femrave, punësimi dhe pavarësia ekonomike, shënojnë vlera të pafavorshme në Kosovë. Sidoqoftë, këto fusha tregojnë për një ndryshim vendimtar në të ardhmen: shkalla e femrave të regjistruara në programet edukative është në ngritje, gjë që rezulton në mundësi më të mira punësimi.<sup>59</sup>

---

<sup>57</sup> Sipas të dhënave të ZSK-së, në vitet e fundit shkalla e divorcit ishte në rritje (për një përafërsi më të vërtetë, nevojiten të dhënat afatgjata). Në vitin 2004, shkalla e divorcit numëronte 7.9% të martesave, dhe më 2006 dhe 2007 deri në 9.3%. Gati gjysma (48.5%) e të gjitha grave të divorcuara ishin të moshës mbi 29 vjeçare, prej të cilave 4.6% ishin të moshës nën 20 vjeçare kur u divorcuan, 45.1% më të reja se 25 vjeç, si dhe 50.3% më të reja se 30 vjeç (ZSK, *Women and Men in Kosovo 4/2009*; Tabela: Marriages and Divorces, 2002-007, f. 24; Tabela: Divorces Classified by Sex and Age-Groups, 2006 and 2007, f. 25). Sllovenia përjeton një zbritje të rregullt të martesave, që e bën të renditet e fundit ndër shtetet e BE-së sa i përket martesave të reja; mosha e të martuarve është në rritje (në vitin 2005, një e martuar ishte mesatarisht e moshuar 28.2 vjeç, ndërkaq një i martuar ishte mesatarisht 30.6 vjeç i moshuar), gjithashtu në rritje është edhe numri i divorceve: në vitin 1980, raporti ndërmjet numrit të divorceve dhe martesave të reja ishte 18.7%, më 1990 21.8%, më 2004 36.8%, si dhe 45.9% në vitin 2005. Në vitin 2005, divorci mesatar ndodhi përafërsisht pas 16 viteve të martesës [http://www.stat.si/novica\\_prikazi.aspx?ID=363](http://www.stat.si/novica_prikazi.aspx?ID=363) (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<sup>58</sup> Rašević, Mirjana, ed. 2000. »Žena i rađanje na Kosovu i Metohiji.« In: *Stanovništvo*, št. 1-4, str. 188-194. Beograd: Centar za demografka istraživanja Instituta društvenih nauka. <http://scindeks-clanci.nb.rs/data/pdf/0038-982X/2000/0038-982X0001188B.pdf>, përdorur më 20 Qershor, 2009.

<sup>59</sup> (ZSK, *Women and Men in Kosovo 4/2009*, Education, 27-36; Labor Market, 37-45).

## **Mashkullia**

Para përfundimit, duhet gjithashtu të cekim specifika të tjera krahasuese të strukturës së popullsisë kosovare: femrat janë minoritet në popullsinë e Kosovës. Sipas të dhënave të ZSK-së, meshkujt gjithmonë kanë përbërë shumicën e popullsisë,<sup>60</sup> gjë që e bën të veçantë Kosovën në krahasim me shtetet e tjera evropiane, sepse nuk ka asnjë vend tjetër në Evropë ku meshkujt përbëjnë shumicën e popullsisë.<sup>61</sup> Kosova shënon mashkullinë relativisht më të madhe së paku që prej kohës së Jugosllavisë Socialiste; si p.sh., në vitin 1961, Kosova numëronte 1045 meshkuj për 1000 femra, përderisa Sllovenia arriti minimumin e Jugosllavisë prej 917.<sup>62</sup> Kur diskutohet raporti gjinor brenda popullatave ku meshkujt përbëjnë shumicën, mund të vërehet një fakt interesant: në tërë këto mjedise, foshnjat e gjinisë mashkullore janë dominues tek të porsalindurit; sidoqoftë, shkalla e tyre fillon të zbresë mbas lindjes. Meshkujt e të gjitha moshave paraqesin një shkallë më të madhe të mortalitetit se femrat, gjë që vlen edhe tek lindjet e frytit të vdekur. <sup>63</sup> Në pesëdhjetë vitet e fundit, Kosova shënoi

---

<sup>60</sup> Në vitin 2002, Meshkujt përbënin 50.5% të të gjithë popullsisë së Kosovës, 51% në vitin 2003, 50.8% më 2004, 51.2% më 2005, si dhe 50.5% për vitet 2006 dhe 2007 (ZSK, *Women and Man in Kosovo*, 3/2009, Tabela: Total population in Kosovo (in 1000's), f.12).

<sup>61</sup> Mashkullia në Evropë, e matur për 100 femra, ndryshon nga 85 (Ukrainë dhe Estoni) dhe 99 (Irlandë, Holandë, Norvegji, Serbi dhe Mal të Zi), dhe arrin në raport të barabartë (100:100) vetëm në Maqedoni dhe Islandë. Mashkullia e lartë u shënuar në disa vende jo-Evropiane, më e larta duke qenë në Emiratet e Bashkuara Arabe (214:100), Kuvajt (150:100), Oman (128:100), Pakistan dhe Kinë (106:100), Indi (105:100), Iran dhe Irak (103:100) (UN Report for 2004, Tabela: VIII.1, Total population by sex and sex ratio, by country [http://www.un.org/esa/population/publications/WPP2004/2004Highlights\\_finalrevised.pdf](http://www.un.org/esa/population/publications/WPP2004/2004Highlights_finalrevised.pdf) (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<sup>62</sup> Vogelnic, Dolfe. 1979. *Uvod v socialnoekonomsko statistiko*. Ljubljana: Univerza v Ljubljani, Ekonomska fakulteta Borisa Kidriča, f. 98.

<sup>63</sup> Sipas të dhënave statistikore të gjetura nga shekulli 19, shtetet e Evropës Qendrore dhe Perëndimore rregullisht tregojnë mbizotërim të femrave; një situatë e ngjashme është duke u zhvilluar në mënyrë të shpejtë edhe në SHBA. Mbizotërimi i meshkujve është zakonisht i parë në shtetet e Evropës Juglindore dhe lindore. Arsyet për një situatë të tillë duhet të

një zbritje në shkallën e mashkullisë, e cila në vitet e fundit sillej prej 10021 (në vitin 2002 dhe 2007) dhe 1050 (në vitin 2005). Të dhënat rreth gjinisë së të porsalindurve tregojnë që në vitin 2004 mashkullia numëronte deri në 108, vlerë e cila përbën 52% tek të porsalindurit. Nga pikëpamja krahasuese, sipas statistikave demografike, këto të dhëna shfaqin një fenomen interesant ndërmjet raportit të porsalindurve femra dhe meshkuj, që gjithashtu përdoret për parashikime demografike, është 105:100<sup>64</sup>, që do të thotë në Kosovë ka më shumë të lindur të gjinisë mashkullore se në të gjitha shtetet evropiane. Tek *Analiza e Statistikave Jetësore* gjithashtu theksohet se shkalla e mashkullisë varet nga njohja e etnisë prindërore, si p.sh., tek joshqiptarët, kryesisht serbët, shënohen vlera shumë më të ulëta, <sup>65</sup> si dhe nga tipi i mjedisit; mjediset urbane shënojnë vlera më të ulëta, ndërsa ato rurale më të larta.

“Komunat me pjesëmarrje më të lartë të popullatës serbe kanë vlera më të ulëta të koeficientit të mashkullisë ndërkaq koeficienti femëror është i lartë. Kryesisht në komunat me pjesëmarrje të popullsisë shqiptare, koeficienti i mashkullisë është më i lartë, përderisa komunat me sipërfaqe urbane kanë koeficient mesatar të mashkullisë dhe femërisë tek fëmijët. Harta 6 tregon se shumica e komunave (25) kishin një koeficient të mashkullisë në mes të 100 dhe 125 ose 1000 dhe 1250. Komunat me shumicë serbe (përkundër të dhënave të pakta) tregojnë koeficient të ulët të mashkullisë krahasuar me

---

gjinden në specifikat kulturore e jo ato natyrore; puna në teren ka treguar se komunitetet e mëdha patriarkale tentojnë të mos e raportojnë saktë numrin e vajzave sepse janë vetëm djemtë ata që vlejnë të përmenden (Wagner 1992; Todorova 1990). Në Jugosllavi, raporti gjinor ishte në favor të femrave në Serbi, përderisa në Kosovë dhe Maqedoni qëndroi i barabartë, edhe nëse proporcioni i femrave gradualisht ngrihej. Pyetja se pse janë disa kultura më të “suksesshme” kur bëhet fjalë për mbijetesën e meshkujve dhe pse shoqëritë bashkëkohore industriale vërtetuan të jenë më pak “mashkull-dashëse”? (Žnidaršič Žagar 2000, 47-61)

<sup>64</sup> Vogelnic, Dolfe. 1979. *Uvod v socialnoekonomsko statistiko*. Ljubljana: Univerza v Ljubljani, Ekonomska fakulteta Borisa Kidriča, f. 170.

<sup>65</sup> Do të ishte interesante të krahasohej shkalla e mashkullisë nga etnia për një periudhë të gjatë kohore, sepse mund të supozohet se mashkullia filloi të rritej pas krijimit të Jugosllavisë Socialiste, e shoqëruar me një rritje graduale të popullsisë shqiptare në Kosovë.

komunat me popullatë shqiptare. Këto të dhëna duhet të analizohen thellësisht në mënyrë që të vërtetohet nëse faktori për këtë dallim është ndikimi natyror apo ndonjë ndikim tjetër”.<sup>66</sup>

Shënimi i fundit është padyshim i arsyeshem; sidoqoftë, konkluzionet e analizës aplikohen në të gjitha mjediset, jo vetëm në Kosovë: në përgjithësi, numri i meshkujve të porsalindur në të gjitha popullsitë është më i lartë se ai i femrave të porsalindura, përveç vendeve që ushtrojnë praktika të mbytjes së rregullt të farës së anëtarëve të njëjës gjini, ashtu si vendet e Azisë Juglindore që praktikojnë mbytjen e foshnjës femërore apo karakteristikat e abortimit në bazë të seleksionimit gjinor. Pyetja se pse popullsia shqiptare ka një shkallë relativisht të lartë të mashkullisë është shumë interesante për hulumtuesit, nën kushtin, gjithsesi, se refuzohet supozimi se shkalla e lartë e meshkujve është produkt i specifikave “natyrale” të popullsisë shqiptare; supozimi rreth specifikave “natyrale” është edhe më e diskutueshme kur merret parasysh fakti që Kosova gjithmonë ka qenë territor shumë tranzicional, vendtakim i shumë etnive, si dhe fakti që meshkujt shqiptarë gjithmonë kanë demonstruar kapacitet të lartë të asimilimit. Prandaj, arsyet për shkallën e lartë të mashkullisë duhet të kërkohen tek specifikat kulturore, të cilat e bëjnë këtë çështje të ndjeshme dhe shtrojnë nevojën për grumbullimin e të dhënave të pagjetura. Të dhënat lidhur, si p.sh., me gjininë e foshnjave të vdekura janë joadekuate dhe të pagjetura, qofshin ato nga pikëpamja përzgjedhëse apo e përcaktuesve të tjerë; një tjetër fakt i rëndësishëm për këtë hulumtim do të ishte njohja e prejardhjes etnike të nënave. Së bashku, analiza e lindjeve në Kosovë<sup>67</sup> si dhe tabela hyrëse “Zhvillimi i jetës në Kosovë” (7) nuk tregojnë të dhëna mbi numrin e lindjeve të frytit të vdekur edhe nëse kjo e dyta e parashikon atë; sipas tabelës 1.21, që paraqet lindjet e frytit të vdekur sipas gjinisë, numri i përgjithshëm i fëmijëve të vdekur djem dhe vajza numëron deri më 160 dhe 120, respektivisht

---

<sup>66</sup> ZSK, *Analysis of the Vital Statistics 7/2008*, 24.

<sup>67</sup> ZSK, *Statistics of Births in Kosovo, 7/2008*.

(27), ndërkaq sipas tabelës 1.23, e cila paraqet të lindurit e vdekur vetëm sipas muajit dhe gjinisë, femrat dhe meshkujt numëronin 160 dhe 120, respektivisht (29). Duke i krahasuar analizat e ndryshme, mund të nxirret si përfundim se tabela 1.23. shfaq të dhëna jokorrekte si dhe Kosova (gjithashtu) shfaq shkallë më të madhe të lindjeve të frytit të vdekur të meshkujve sesa të femrave. Sa i përket procesit të “balancimit”, raporti i ndryshëm i gjinisë ndikohet jo vetëm nga mashkullia në grupin e të porsalindurve, por gjithashtu – si në rastin e Sllovenisë (dhe shteteve tjera) – mortaliteti më i lartë i meshkujve në të gjitha grupmoshat, Kosova shfaq një situatë idiosinkretike, që mund të jetë e lidhur me të dhënat jo-adekuate: sipas të dhënave mbi vdekshmërinë e foshnjave, mortaliteti i foshnjave të gjinisë femërore ishte më i lartë deri në vitin 2005, kur ky trend ndërroi kahe.<sup>68</sup> Në mënyrë interesante, autori i kësaj analize propozon hipotezën që gjithashtu aplikohet për mjedise tjera dhe mbetet e panjohur: “Nëpër vite, vdekshmëria e foshnjave më të reja se një vit tregon se imuniteti i gjinisë mashkullore është më i vogël dhe më jostabël krahasuar me gjininë femërore” (f. 20) apo “thuhet se foshnjat femra janë imune gjatë ditëve apo muajve të parë të jetës; të dhënat për vitin 2004 tregojnë që 415 foshnje, 43.9% e të cilave ishin meshkuj ndërsa 56.1% femra”.<sup>69</sup> Të dhënat e cituara nga autori janë të pasakta në qoftë se krahasohen me burime tjera, sipas të dhënave të ZSK-së<sup>70</sup>, në vitin 2004 numri i foshnjave femra dhe meshkuj të vdekur numëronte deri në 233 (56%) dhe 182 (42%) respektivisht. Në çdo rast, citimet e mësipërme tregojnë që autori përkrah një besim të përgjithshëm që femrat e posa-lindura kanë imunitet “natyral” më të fortë se sa meshkujt e posa-lindur, gjë që mund të ketë pasoja tragjike për gjininë femërore. Prandaj një hulumtim i thellë i shkaqeve të lindjeve të frytit të vdekur do të ishte i mirëseardhur.

Përfundimi që mund të nxirret nga ky krahasim ndërmjet mortalitetit të femrave dhe meshkujve në grupmosha të

<sup>68</sup> ZSK, *Women and Men in Kosovo*, 4/2009, 19.

<sup>69</sup> ZSK, *Analysis of the Vital Statistics*, 7/2008, 32.

<sup>70</sup> *Women and Men in Kosovo*, 4/2009, 19.



ndryshme, është që moshë më e rrezikshme për femra është e lidhur me lindjen, së pari me lindjen e tyre e pastaj të fëmijëve të tyre,<sup>71</sup> ndërsa ritmi i vdekjes tek meshkujt është në anën e kundërt, duke pasur moshën e re dhe moshën e re madhore si periodën më të rrezikshme, si dhe moshën rreth viteve të pesëdhjeta. Të dhënat e ofruara tregojnë që në Kosovë vdekja amësore është ende problem dhe një element i rëndësishëm në vendosjen e raportit të gjinisë.<sup>72</sup> Sa i përket raportit ndërmjet grupmoshave të ndryshme, është e pamundur që të gjendet një e vërtetë pasi që secili dokument statistikor shfaq shpërndarjen e gjinive në moshë; sipas këtyre të dhënave<sup>73</sup>, Diagrami: Popullsia sipas grup-moshave (%), 14), grupi më i madh i femrave është rreth moshës 25 dhe 54 vjeçare, rast që vlen edhe për meshkuj, edhe pse në një masë më të vogël pasi që ka pak më shumë meshkuj se sa femra tek grupmoshat e reja. Nëse njeri tenton të matë proporcionet e femrave dhe meshkujve përbrenda grupmoshave të veçanta duke pasur parasysh piramidën e popullsisë<sup>74</sup> vërehet se numri i femrave është më i vogël se ai i meshkujve nën moshën 50 vjeçare, ose më saktësisht, në moshën 55 vjeçare.

---

<sup>71</sup> Në Kosovë mortaliteti femëror është më i larti në lindje, por fillon të zbrësë dukshëm pastaj duke u rritur prapë tek grupmoshat 20 vjeçare kur shumica e femrave hyn në periudhën e amësisë. Pas moshës 45 vjeçare atëherë kur periudha martesore mbaron, vërehet një zbritje tjetër e përcjellë me një rritje të rregullt (SOK, *Analysis of the Vital Statistics*, 7/2008; Diagrami 29, 32).

<sup>72</sup> Fatkeqësisht, nuk gjendet asnjë e dhënë në vdekshmërinë amësore në Kosovë; në Slloveni, vdekja tek femrat është e shkaktuar nga komplikimet gjatë shtatzënisë, punës apo periudhave të pas-lindjes është shumë e rrallë: prej vitit 1985 deri në vitin 2007, një maksimum prej 3 rasteve kanë ndodhur në kohë vjetore, <http://www.stat.si/pxweb/Dialog/Save-show.asp> (Përdorur më 20 Qershor, 2009) Tabela: Deaths by cause of death and sex.

<sup>73</sup> ZSK, *Women and Men in Kosovo*, 4/2009.

<sup>74</sup> <http://www.censusbureau.biz/ipc/www/idb/country.php>, përdorur më 20 Qershor, 2009, piramida e popullsisë.

## **Përfundim**

Nuk ka asnjë dyshim që të hulumtosh popullsinë kosovare dhe lëvizjet e saj është një sfidë e vërtetë. Rajoni tregon një strukturë unike të popullsisë të pakrahasueshme me situata të tjera në zonën evropiane. Në Kosovë, tranzicioni demografik, i cili ka përfunduar, si p.sh. në rastin e Sllovenisë, është ndalur, gjë që ka bërë lindjen e situatave shumë të veçanta.

Përderisa evolucioni dhe përfundimi i tij në Slloveni janë drejtuar nga modernizimi i shoqërisë, e cila mbylli jo vetëm transformimin e ekonomisë dhe shoqërisë, por edhe të jetës ditore, evolucioni dhe ndalja e tij në Kosovë u ndikuan nga zhvillimet politike të nxitura në mënyrë të madhe nga konfliktet ndëretnike si element çelës dhe si proces i emancipimit kombëtar të komunitetit shqiptar në Kosovë. Ajo që shumica e sferës politike evropiane, përfshirë edhe atë sllovene, përjetuan në shekullin 19, ndodhi në Kosovë në shekullin 20, në rrethana plotësisht të tjera. Rezultati kryesor i këtij procesi, i cili ishte edhe një nga pikat më nevralgjike të Jugosllavisë Socialiste, është ngecje e modernizimit, që ishte ndëshkuar në Kosovë si një intervenim ushtarak nga jashtë dhe ishte kanosur si rrezik i interesit kombëtar të komunitetit shqiptar. Këmbëngulja shqiptare në gjoja vlerat tradicionale (dhe etnikisht të ndryshme) dhe jetesën pengojnë me sukses transformimin dhe ndarjen e gjetjeve të reja shkencore dhe teknologjisë që do të ndërhyjnë rrënjësisht në jetën e individëve dhe t'i ndërronin pritjet dhe shpresat e tyre. Është e vështirë të thuhet se deri në çfarë mase nataliteti më i lartë është përdorur si njëri nga instrumentet për ta mbajtur dallimin etnik dhe, për pasojë, dominimin e përgjithshëm të shqiptarëve në Kosovë; çfarë mund të thuhet me siguri është që superioriteti në numër i komunitetit shqiptar në Kosovë shpesh është përdorur (dhe keqpërdorur). Femrat janë ato që shumicën e kohës e paguajnë çmimin e qartë, sepse ato nuk e kishin mundësinë e organizimit të jetës në një mënyrë të pavarur dhe më të sigurt. Kështu, përmirësimi i kushteve jetësore të femrave është e rëndësishme së veçantë kur flitet për ardhmërinë e Kosovës si shtet i pavarur. Në të vërtetë, problemi nuk qëndron tek lindjet, por tek fakti që mundësia e lirisë së zgjedhjes tek individit - e posaçërisht

femra- është e limituar. Në këtë sferë, për mendimin tonë, modernizimi i shoqërisë kosovare dhe shqiptare ishte (me siguri) i penguar në mënyrë të qëllimtë në shekullin e kaluar.

Sot, Kosova është një sipërfaqe specifike në fushën demografike, ekonomike dhe politike, si dhe pranë një transformimi të madh. Duke shikuar trendët e saj demografikë, Kosova ka arritur në një pikë kur tranzicioni demografik (me siguri) do të fillojë të zhvillohet me një ritëm të përshpejtuar dhe të transformojë përfundimisht tërë shoqërinë. Sipas studimit tonë, procesi do të përshpejtohet nga trendët e vërejtur qartë në vitet e kaluar: rënia e natalitetit, rënia për disa shkallë e mortalitetit, “balancimi” i raportit gjinor, veçanërisht si rezultat i zbritjes së nivelit të vdekjes amësore dhe të meshkujve të grupmoshave të reja, si dhe transformimi gradual i strukturës së moshës së popullsisë. Këta trendë demografikë do të jenë kyç për zhvillimin e mëtejshëm të Kosovës si dhe afrimin e shtetit qysh sot drejt shteteve partnere evropiane. Evolucionit të tyre do t’i nevojiten ndryshime ekonomike dhe shoqërore: ngritje në nivelin e përgjithshëm të edukimit të popullsisë, veçanërisht të femrave, përmirësimin, adoptimin dhe implementimin e ligjeve dhe të shërbimeve përkrahëse, veçanërisht në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies, me qëllim të ngritjes së standardeve të popullsisë, veçanërisht të femrave, dhe zhvillimin e sektorëve ekonomikë që bëjnë premtimin e hapjes së vendeve të reja të punës, veçanërisht për femra, si dhe zhvillimin e një strukture ekonomike më të harmonizuar. Kosova është një shtet i ri, falë moshës së popullsisë e jo krijimit, që është pa dyshim potenciali më i madh i zhvillimit dhe (ndoshta edhe më e rëndësishme) i sfidës.

*Përktheu nga anglishtja: Fisnik Bajrami*

## **Literatura**

- Cvijić, Jovan. 1966. *Balkansko poluostrvo*. Beograd: Zavod za izdavanje udžbenika SR Srbije.
- Drnovšek, Marjan. 1988. “Nekatere evidence o izseljevanju v Ameriko pred prvo svetovno vojno.” In: *Kronika*, št. 3, str. 205-217. Ljubljana.

- Ferrin Weber, Adna. 1965. *The Growth of Cities in the Nineteenth Century. A Study in Statistics*. New York: Cornell University Press.
- Horman, Elizabeth. 1999. »Report on Breastfeeding Consulētancy in Kosovo. September-December 1999.« <http://www.euro.who.int/Document/Nut/infantkosovo.pdf>, (përdorur më 20 Qershor, 2009).
- Kalc, Aleks. 1996. »Ladijske potniške evidence kot vir za zgodovino izseljenstva, s posebnim ozirom na izseljenske sezname tržaškega pristanišča.« In: *Dve domovini*, št. 7, str. 51-69.
- Kalc, Aleks. 1997. »Razvojni obrisi izseljenske zakonodaje v 19. stoletju in do prve svetovne vojne.« In: *Dve domovini*, št. 8, str. 9-35.
- Livi Bacci, Massimo. 2005. *Prebivalstvo v zgodovini Evrope*. Ljubljana: \*cf.
- Malcolm, Noel. 2002. *Kosovo: A Short History*. London: Pan Books.
- Melik, Anton. 1963. *Slovenija. Geografski opis*. Ljubljana: Slovenska matica.
- Prilozi za izgradjivanje društvenih stavova o planiranju porodice i regulisanju uslova prekida trudnoče*. 1968. Beograd.
- Rašević, Mirjana, ed. 2000. »Žena i rađanje na Kosovu i Metohiji.« In: *Stanovništvo*, št. 1-4, str. 188-194. Beograd: Centar za demografka istraživanja Instituta društvenih nauka. <http://scindeks-clanci.nb.rs/data/pdf/0038-982X/2000/0038-982X0001188B.pdf> (përdorur më 20 Qershor, 2009).
- Rožman, Irena. 2004. *Peč se je podrla! Kultura rojstev na slovenskem podeželju v 20. stoletju*. Ljubljana: Knjižnica Glasnika slovenskega etnološkega društva.
- Socialni aspekti planiranja porodice u Jugoslaviji*. 1974. Beograd: Jugoslovenska konferencija za socijalne delatnosti.
- Šaranović, Mihailo, ed. 1981. *Enver hodžina Albanija*. Beograd: Tanjug.
- Šircelj, Milivoja. 2006. *Rodnost v Sloveniji od 18. do 21. stoletja*. Ljubljana: Statistični urad Republike Slovenije.
- Todorova N., Maria. 1990. *Balkan Family Structure and the European Pattern*. The American University Press.
- Trifunoski, Jovan. 1988. *Albansko stanovništvo u Makedoniji*. Beograd: Književne novine.
- Vogelnik, Dolfe. 1979. *Uvod v socialnoekonomsko statistiko*. Ljubljana: Univerza v Ljubljani, Ekonomska fakulteta Borisa Kidriča.
- Zupančič, Jernej. 2008. »Albansko vprašanje v luči političnoteritorialne rekonstrukcije Balkana.« In: *Razprave in gradivo*, št. 55, str. 6-49. Ljubljana: Inštitut za narodnostna vprašanja. <http://www2.arnes.si/~ljinv16/RIG/RIG%2055/Zupancic.pdf> (përdorur më 20 Qershor, 2009)

- Žnidaršič Žagar, Sabina. 2000. *Ora et labora – in molči, ženska! Pregled demografije dežele Kranjske in pridobitnosti žensk v desetletjih 1880-1910*. Ljubljana: \*cf.
- Žnidaršič Žagar, Sabina. 2008. *Ženske so pa vzrasle svetlejšje dolžnosti nego kuhati in prati... Podoba in pojavnost žensk na Slovenskem: Slovenke, od sredine 19. stoletja do 2. svetovne vojne*. Ljubljana: Digitalna knjižnica, Zbirka Compendija.
- Wagner A., Richard. 1992. *Children and Change in Orašac, 1870-1975: A Serbian Perspective on Fertility Decline*. University of Massachusetts.

#### Viri

Statistični urad Republike Slovenije (SURS)

[http://www.stat.si/tema\\_demografsko\\_prebivalstvo.asp](http://www.stat.si/tema_demografsko_prebivalstvo.asp) (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<http://www.stat.si/pxweb/Dialog/Saveshow.asp> (përdorur më 20 Qershor, 2009).

<http://www.stat.si/doc/pub/rr798-2003/5/T05-02-01.htm> (përdorur më 20 Qershor, 2009).

[http://www.stat.si/novica\\_prikazi.aspx?ID=363](http://www.stat.si/novica_prikazi.aspx?ID=363) (përdorur më 20 Qershor, 2009).

*Slovenija v številkah*. 2008. Ljubljana: SURS.

#### ZSK

Women and Men in Kosovo. 04/2009.

Statistics of Deaths in Kosovo 2007. 01/2009.

Statistics of Marriages and Divorces in Kosovo 2007. 01/2009.

Statistics of Births in Kosovo 2007. 07/2008.

Analysis of the Vital Statistics for the Newest Period of Time. 07/2008.

Demographic Changes of the Kosovo Population 1948-2006. 02/2008.

[http://www.ks-gov.net/ESK/eng/index.php?option=com\\_docman&task=cat\\_view&gid=8&Itemid=8](http://www.ks-gov.net/ESK/eng/index.php?option=com_docman&task=cat_view&gid=8&Itemid=8) (përdorur më 20 Qershor, 2009).

*Jugoslavija 1918-1988. Statistički godišnjak*. 1989. Beograd: Savezni zavod za statistiku.

U. S. Census Bureau <http://www.censusbureau.biz/ipc/www/idb/country.php> (përdorur më 20 Qershor, 2009).

UNMIK, Population <http://enrin.grida.no/htmls/kosovo/SoE/popullat.htm> (përdorur më 20 Qershor, 2009).

UN, World Population Prospects. The 2004 Revision [http://www.un.org/esa/population/publications/WPP2004/2004Highlights\\_finalrevised.pdf](http://www.un.org/esa/population/publications/WPP2004/2004Highlights_finalrevised.pdf) (përdorur më 20 Qershor, 2009).